

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17 PRILL 2003**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 17. 04. 2003. GOD.**

**PRILL - APRIL
2003**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme
2. Shqyrtimi i dytë i Projekt ligjit për Arkivat dhe Lëndën Arkivore
3. Shqyrtimi i dytë i Projekt ligjit për Vendosjen e Tatimit në Pronën e Palujtëshme
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Koperativat bujqësore
5. Parashtrimi i pyetjeve
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 24 Prill 2003:
 - 6.1 Shqyrtimi i nismës së Grupit parlamentar të LDK-së, për nxjerrjen e Ligjit për Zgjedhjet në Kosovë
 - 6.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rrugët
 - 6.3 Shqyrtimi i parë i Projekt ligjit për Plehrat Artificiale

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrësia të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Друго разматрање Нацрт закона о Архивама и Архивској Грађи
3. Друго разматрање Нацрт закона о успостављењу Пореза на Непокретну Имовину
4. Прво разматрање Нацрт закона о пољопривредним Задругама
5. Постављање питања
6. Предлог дневног реда за пленарну седницу 24 Априла 2003:
 - 6.1 Разматрање иницијативе Парламентарне групе ДСК о доношењу Изборног закона на Косову
 - 6.2 Прво разматрање Нацрт закона о Путевима
 - 6.3 Прво разматрање Нацрт закона о Вештачким ћубровима

Опомена : *Питања упућена Влади за усмене одговоре*

"Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се оћекује одговор"
(Правило 21.2 са Привремени пословник)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting
2. Second reading of the Draft Law on Archives and Archiving Subject
3. Second reading of the Draft Law on Impose of the Tax on Immovable Property in Kosovo
4. First reading of the Draft Law on Agricultural Cooperatives
5. Questions
6. Proposal for agenda of 24 April 2003 for Plenary Meeting:
 - 6.1 Review on the initiative of the LDK Parliamentary group to come out the Law on the general elections of Kosovo
 - 6.2 First reading of the Draft Law on the Roads
 - 6.3 First reading of the Draft Law on the Pesticides

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 17 PRILL 2003

Seanca filloi punën në orën 10,00.

**KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI,
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES, SABRI HAMITI, ANËTAR I KRYESISË
SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes kolegë deputetë. Mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare.

Rendi i ditës është përcaktuar një javë më parë.

Shpresoj se të gjitha materialet e nevojshme janë në rregull dhe me kohë i keni marrë.

Prandaj, mendoj se mund të procedojmë me atë rend të ditës. Më parë do ta marrë fjalën kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ:

Zoti kryetar, e nderuar Kryesi, të nderuar kolegë deputetë,

Kërkova fjalën që në emrin tim, por edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës dhe besoj se është edhe ndjenjë e juaj të shprehim pakënaqësinë për gjendjen energjetike në Kosovë, të cilën, tashmë, e konsiderojmë si një kolaps energjetik që po ndodhë në Kosovë.

Jam i vetëdijshëm se ne kemi diskutuar këtu, në këtë Kuvend, këtë çështje. E di po ashtu se është çështje e kompetencave të rezervuara, sikur që jemi mësuar të dëgjojmë, por, po ashtu, të nderuar kolegë, ne nuk mund ta heshtim këtë gjendje dhe kërkoj që Kuvendi ta shprehë pakënaqësinë për këtë gjendje të rëndë dhe të marrë veprime konkrete për dalje nga ky kolaps energjetik.

Gjendja e tashme 5 orë pa rrymë dhe 1 orë me rrymë është vërtetë e papërballueshme. Ky kolaps energjetik është duke ngulfatur, jo vetëm jetën e qytetarëve tanë, por edhe ekonominë dhe është duke sjellur pasoja shumë të rënda në përgjithësi për ne në Kosovë. Mendoj se ne

duhet të veprojmë por kësaj here të veprojmë seriozisht, me seriozitetin e duhur, sepse çështja është serioze. Pra, kërkoj nga Parlamenti i Kosovës, nga kolegët tanë këtu, që të gjejmë mënyra, që të gjejmë instrumente të veprojmë që gjendja të ndryshojë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të falemnderit Ramush. E ka fjalën Dragisha Kërstoviq.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poštovani predsedniče, dame i gospodo poslanici, gospodo ministri, Ja u ime Parlamentarne grupe Koalicije «Povratak» imam jedan predlog. Naime, hoću da predložim da se sa današnjeg dnevnog reda skine tačka – Drugo čitanje Zakona o uspostavljanju poreza na nepokretnu imovinu na Kosovu iz više razloga. Prvo, na taj Zakon je stavljeno dosta amandmana i svi ti amandmani su bili u proceduri kod ovlašćenih komisija i kod poslaničkih grupa a drugo mislim da je Zakon o uspostavljanju poreza u pojedinim svojim delovima veoma sporan i da može da ima vrlo štetne implikacije kada bude njegova primena u praksi a naročito želim da ukažem na odredbu člana 18. predloženog Zakona koja može da ima veoma štetne posledice na sve građane Kosova. Odredba člana 18. je veoma radikalna i suviše stroga i ja bih zamolio da se razmotri mogućnost da se Drugo čitanje po ovom Predlogu zakona odloži i da se ostavi mogućnost da se podnese još amandmana i da se ti amandmani sistematizuju sa ostalim amandmanima koji su već u proceduri i da posle toga imamo jednu ozbiljnu raspravu o jednom ozbiljnom zakonu kao što je Zakon o uspostavljanju poreza na nepokretnu imovinu.

Mislim da je reč o zaista vrlo važnom zakonu. Takve ocene su uostalom imale i sve komisije i mislim sve poslaničke grupe i nije dovoljno da se za dve nedelje ili eventualno tri nedelje završi rasprava po jednom ovako značajnom Zakonu koji itekako će se ticati svih građana koji žive na Kosovu i metohiji. Zato bih zamolio predsednika da ovaj moj predlog stavi na glasanje, dakle da se ova tačka odloži okdnosno da se drugo čitanje Zakona o porezima na nepokretnu imovinu skine sa današnjeg dnevnog reda i da se stavi na dnevni red koji će biti dnevni red zasedanja za 24 april, s obzirom da će na tom dnevnom redu biti samo dva prva čitanja zakona i mislim da će imati vremenskog prostora da se ovo pitanje razmotri. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit Dragisha. Do t'ju lutja me sa vijon: Atë që inicoi zoti Haradinaj është problem që nuk mund më të heshtet sepse është gjendje alarmante dhe e patolerueshme. Por ne nuk e kemi as në rend të ditës, as nuk është që mund ta fusim menjëherë me procedurë të ngutshme dhe sot ta procedojmë sepse as nuk jemi të përgatitur se cilat masa duhet ndërmarrë. Por, propozoj që shefat e grupeve parlamentare, në një takim të veçantë mes veti, pastaj po patën nevojë edhe me mua, dhe të shohim se cila do të jetë mënyra më e mirë e procedimit me problemin, sepse ka e dhe shumë çështje tjera të g rumbulluara dhe mendoj se ajo do të jetë rrugë më e mira.

Sa i përket propozimit të zotit Kërstoviq, është për shumë rrespekt sepse Grupi Parlamentar e propozon dhe do të thotë ka masën kritike të nevojshme që të procedojmë sipas Rregullores. Prandaj vë në votim atë që propozoi.

Kush përkrah propozimin e Grupit parlamentar të Koalicionit “Kthimi”?

Më parë, zoti Ivanoviq, dëshiron ta marrë fjalën.

OLIVER IVANOVIĆ:

Poštovane kolege,

Ja imam, više proceduralne prirode, primedbu zbog koje mislim da bi smo svakako morali odložiti ovu tačku dnevnog reda koju su na svojoj zajedničkoj sednici usvojile dva odbora, dva glavna odbora – znači Odbor za prava i interese zajednica i Odbor za budžet. Naime ti odbori broje 12 odnosno 14 člana. Sednici je prisustvovalo 15 ljudi od kojih je jedan napustio sednicu, znači pre glasanja, i dovodi nas ozbiljno u sumnju da su oni uopšte imali kvorum. Zapisnik sa te sednice nismo dobili i ne objašnjava u tom delu koliko člana kojeg odbora je bilo prisutno i koliko članova kojeg odbora je glasalo za predloge amandmana. Vrlo je važno da većina članova odba odbora, pojedinačno, glasaju i daju saglasnost ili podršku tim amandmanima.

Ukoliko bi sada ovako, teoretski gledano, 26 članova koji su pozvani odnosno koji su bili obavezni da prisustvuju sednici... Možemo lako spekulirati sa tim, da je recimo 14 bilo iz jednog a samo dva iz drugog odbora. Prava i interesi zajednica na taj način nisu zaštićeni i ja mislim da je to principijelne prirode naša primedba i mislim da bi tu primedbu bi trebali usvojiti i da mi ovo odložimo za neku sledeću sednicu. Hvala vam.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Vetëm t’ju përkujtoj, ju lutem të gjithëve. Projektligji është miratuar në parim më 27 mars 2003. Komisionet parlamentare kanë bashkëpunuar në mes veti dhe Kuvendit i kanë rekomanduar amendamentet në tekstet e Projektligjit. Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale, në bazë të rekomandimeve të komisioneve kryesore dhe komisioneve funksionale, ka përgatitur listën e radhitjes së amendamenteve të propozuara nen për nen me tekstin e plotë të amendamenteve, emërtimin e propozuesit dhe qëndrimet e komisioneve relevante lidhur me to.

Prandaj, unë mendoj se Koalicioni “Kthimi” ka të drejtë për propozime të këtilla, por mua më duhet ta rrespektoj procedurën dhe ju ftoj:

Kush është për propozimin që pika 3 e rendit të ditës të heqet sot dhe të shtyhet për shqyrtim në ndonjë seancë tjetër? Ju lutem, me ngritje të dorës, të përcaktohem.

Më lejoni t’ju informoj se të pranishëm në punën e seancës plenare janë 97 deputetë.

Për propozimin për ta hequr nga rendi i ditës këtë pikë kanë votuar 17 deputetë.

Prandaj mund të procedojmë me rendin e propozuar të ditës që keni marrë me kohë të duhur.

Para se ta kalojmë në rendin e ditës – Miratimi i Procesverbalit, t'ju njoftoj se sot, në mëngjes, kam marrë një letër nga dy njerëzit e parë të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, të nënshkruar, Mihajl Shtajner dhe gjenerali Fabio Mini. Në letër kërkohet që Asamblea, do të thotë Parlamenti ynë, ta dënojë aktin që ka ngjarë në Mitrovicë, më 12 prill.

Ne kërkojmë nga Asamblea, që pa eukivoke ta dënojë këtë akt kundër njerëzve të Kosovës dhe unë mendo se të gjithë njëzërit i bashkëngjitemi kërkesës së këtyre dy personave dhe nuk shoh të arsyeshme që për një çështje aq të rëndësishme të debatojmë. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës – Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar. Ne kemi një praktikë këtu, ata që janë të pakënaqur me Procesverbalin ose kanë ndonjë vërejtje apo nëse Procesverbali nuk i përgjigjet realitetit që ka ngjarë në seancën e kaluar, me shkrim të bëjnë vërejtje pranë shërbimeve të caktuara ose, p o p ati n evojë n dokush, këtë mundet e dhe gojarisht ta shprehë. Urdhëroni. Nëse s'ka vërejtje, do të thotë miratohet.

Më lejoni t'i përshëndes ministrat e pranishëm, nëse s'jemi vonuar për këtë.

Pika e dytë është shqyrtimi i Dytë i Projektligjit për arkivat dhe lëndën arkivore.

Projektligji është miratuar në propozim më 20 shkurt 2003. Komisionet parlamentare kanë kryer punën me përgjegjësi, prandaj ne na mbetet që të fillojmë me procedurë... Më lejoni një herë të hap debatën, ju lutem. Urdhëroni, por...

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Poštovani dame i gospodo poslanici,

U ime Koalicije «Povratak» mi smo podneli odredjene amandmane na ovaj Nacrt zakona i od 8 amandmana koje smo mi podneli, 2 su usvojena i to uglavnom ona koja se odnose na greške u odnosu na albansku i srpsku verziju. Međutim, mene čudi da neki amandmani, koji su pre svega odnose na principe... arhivističke principe i pre svega na preporuke od strane Saveta Evrope, a vi znate da smo odoskora, mi, zvanično postali članovi... kao član Saveta Evrope pa ne mogu da shvatim da ti neki principi olako ne prihvate. I još jedna stvar odnosi se na amandman broj 7, da jednostavno univerzitet u Mitrovici se ne priznaje kao univerzitet. To znači automatski da mi nikada nekog člana Srpske zajednice u nekom od ovih organa nećemo da imamo. Da li to jednostavno i znači da Srbe u tim organima i ne želimo? Eto, to su te neke moje primedbe i opaske i ne mogu da shvatim da ovi amandmani koji se pre svega odnose na arhivističke principe da ne budu prihvaćeni. Imam osećaj da ovi koji su pisali ovaj Zakon... ima dosta toga recidiva u prošlosti, sve neke zabrane, sve neki strah da se, ovaj, da se može nešto da se desi, da nešto može da se otkrije. Ja bih vas zamolio da dobro pogledate koji su amandmani koji smo mi podneli i zašto su ti amandmani odbijeni. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë mendoj se kur të vijmë te çdo amendament sipas radhës, atëherë ka vend për këtë që thotë deputeti, sepse kështu në parim nuk mund të bëjmë asgjë. Unë desha të them

se na gëzon fakti që ky Parlament është pranuar në Këshillin e Evropës, por ne po dijmë se nuk është dhe nuk qëndron. Prandaj, Alush, nuk desha ta komentoj këtë sepse është e drejtë e deputetit... Unë do t'ju lutja për tolerancë, për dëgjim të mendimit të kundërt, e që nuk na pëlqen ...Urdhëroni, mund ta merrni fjalën.

ALUSH GASHI:

I nderuar kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë,
Kuvendi i Kosovës ka miratuar Rezolutë me të cilën ka kundërshtuar përmendjen e emrit në preambulën e unionit mes Beogradit e Podgoricës. Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe mendoj se provokimet dhe dezionformatat e tilla në Kuvend të Kosovës janë të dëmshme dhe si të tilla kërkoj nga Kryesia e Kuvendit që të distancohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Dëgjoni. Unë mendoj se çdo akt apo dokument që ka aprovuar ky Parlament ne e rrespektojmë. Prandaj, nuk shoh të arsyeshme që tash edhe një herë të hyjmë në verifikime të tilla. Për atë unë thash, ne kemi informacionet valide dhe deputeti e tha mendimin e vet dhe nuk do të humbim kohë, por procedojmë me Ligjin që është në rend të ditës.

Mendoj, nëse kryetarët e komisioneve që kanë shqyrtuar këtë ligj dëshirojnë ta marrin fjalën, kanë të drejtë ta marrin. Nëse s'dëshironi, atëherë po procedojmë... Urdhëroni, zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI:

Të nderaur kolegë deputetë, i nderuar kryetar,
Nuk është shumë simpatike pas plasimit të çështjeve krejt politike të flasësh për çështje procedurale, por unë megjithatë desha të bëj një vërejtje procedurale dhe një vërejtje parimore dhe të përsëritur procedurale. Do të ishte mirë që vërejtjet procedurale të mundësohen në Kuvendin tonë saherë të kërkojen, konform Rregullores së punës. Vërejtja ime ka të bëjë me praktikën që është vendosur në Kuvendin tonë nga Komisioni për buxhet që jo vetëm të shqyrtojë, jo vetëm të hartojë amendamente por edhe të kontestojë amendamentet e grupeve parlamentare ose të komisioneve parlamentare për çështje që dalin krejtësisht jashtë kompetencave të Komisionit për buxhet. Ne këto çështje i kemi diskutuar edhe në Kryesi dhe kemi vendosur që t'i rekomandojmë dhe i kemi rekomanduar Komisionit për buxhet që të qëndrojë brenda kompetencave të përshkuara me Rregullën 41 të Rregullores së re, madje edhe me Kornizën kushtetuese, Rregullën 9.11.

Nuk është Komisioni për buxhet një super komision që të vendoset mbi komisionet tjera dhe të imponojë pastaj në Kuvend çka të aprovohet e çka të mos aprovohet, edhe për çështje funksionale, që është çështje ekskluzivisht e Parlamentit dhe e komisionit përkatës. Çdo deputet ka të drejtën që të bëjë vërejtje të të gjitha natyrave, por ato mund t'i bëjë si deputet, mund t'i bëjë si grup parlamentar, por si Komision për buxhet nuk mund të shtrohen, ta zëmë, amendamente ose të kontestohen amendamente që kanë të bëjnë me terminologji.

Prandaj, kërkoj që kjo praktikë të ndërpritet dhe kërkoj edhe mirëkuptimin tuaj që as sot të mos shqyrtohen, sidomos në të arëdhmen, amendamentet që dalin jashtë kompetencave të Komisionit për buxhet.

Unë s'po dua t'ju marr kohë, por Rregullorja dhe Korniza kanë përshkruar qartë dhe pa ekuivoke se Komisioni për buxhet mbulon vetëm fushën e buxhetit dhe financave dhe mund të shqyrtojë projektligjet vetëm nga aspekti i implikimeve buxhetore, por jo më shumë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

As nuk jeni shef i grupit parlamentar as anëtar i Kryesisë, ju lutem. Unë i di shumë mirë obligimet e mia dhe po i përcjell me shumë vëmendje, prandaj po procedojmë.

Amendamenti 1, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Do të thotë, nuk kemi diskrepancë mendimesh.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër këtij amendamenti? Asnjë votë kundër.

A abstenon ndokush? 18 abstenime për këtë amendament.

Amendamenti 2, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Askush.

Kush abstenon nga votimi? 18 abstenime, numër i njëjtë i votave si rastin e mëparshëm.

Amendamenti 3, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Askush.

Kush abstenon? 16 abstenime.

Amendamenti 4, Grupi parlamentar i PDK-ës, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe Komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

Kush abstenon? 7 abstenime.

Amendamenti 5, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? 8 abstenime.

Amendamenti 6, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon ndokush? 14 abstenime.

Amendamenti 7, Dy propozime të ndryshme:

- a) Grupi parlamentar "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore,
- b) Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Një herë të votojmë për propozimin,

- a) Grupi parlamentar "Kthimi" pa përkrahje nga komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për këtë amendament? 17 vota janë për.

(Prej vendi, nuk dëgjohe qartë)

Shikoni, të gjithë të kenë abstenuar, 50 + 1 vlenë gjithmonë për çdo vendim, çdo amendament deri sa nuk merret interpretim tjetër në Parlament.

Po pse të detyrohemi në atë mënyrë...

Mirë, kush nuk e përkrah këtë amendament? (Shumica).

- b) Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? 17 vota kundër.
Kush abstenon nga votimi? 3 abstenime.

Amendamenti 8, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër? 1 kundër.
Kush abstenon? 16 abstenime.

Amendamenti 9, Grupi parlamentar i PDK-ës, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni për komunitete, i përkrahur nga Komisioni për buxhet.

Kush është për variantin e parë të Grupit të PDK-ës pa përkrahje të Komisionit funksional dhe të komuniteteve, i përkrahur nga Komisioni për buxhet.

BASHKËKRYESUESI SABRI HAMITI:

Shumë është i ngatërruar. Grupi i PDK dhe Komisioni i buxhetit e kanë bërë këtë propozim, të cilin e kundërshtojnë tjerët, le të jetë pak më i qartë se është hyrë një "për" në fund, dhe një "kundër" në mes.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Kush është për propozimin e Grupit të PDK-ës dhe Komisionit për buxhet?
Ju falemnderit. Ka përkrahje të vetëm 32 deputetëve, prandaj nuk miratohet.

Kush është kundër? 33 vota kundër.
A abstenon kush? 18 abstenime.
Nuk miratohet.

Amendamenti 10, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush? 16 abstenime.

Amendamenti 11, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush? 14 abstenime.

Amendamenti 12, Grupi Parlamentar i PDK-ës, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për?

Urdhëroni...

DRITA STATOVCI:

Ju falemnderit. I nderuar kryetar, të nderuar parlamentarë,
Ky nen është rregulluar gjatë punës dhe është në pajtim me këtë propozim këtu, prandaj nuk ka nevojë të votohet.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Unë besoj se e kuptuat. Tha se amendamenti është diskutuar dhe pastaj aprovuar nga këto komisione. Le të deklarohen bartësit e komisioneve nëse kanë mendim tjetër. Urdhëroni, zoti Çelaj.

LIRAK CELAJ:

I nderuar kryesues, në mungesë së kryesueses së Komisionit për kulturë, unë po dal si nënkryetar i parë dhe desha të sqaroj lidhur me atë çfarë tha Drita dhe se kur kanë bërë vërejtjen këta, këta nuk i kanë patur ato amendamentet që i kemi bërë në gjatë punës së Komisionit dhe kur janë bërë ndryshimet, do të thotë, edhe ata kanë parë se janë harmonizuar dhe janë pajtuar me amendamentin që ka propozuar Komisioni për kulturë. Prandaj nuk ka nevojë të votohet fare.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Do të thotë, propozuesi tërheq amendamentin dhe s'ka nevojë të votohet. Ju falemnderit.

Amendamenti 13, Grupi Parlamentar "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional. Kush është për? Ju doni sqarim. Urdhëroni zoti deputet.

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Gospodine predsedavajući, ja mislim da bi ostali razumeli amandman, treba da bude obrazložen. Ja ne vidim u ovom redosledu da je svaki amandman obrazložen i ja mislim da treba nam omogućiti uvek da obrazložimo zašto smo za nešto. Vidite, ovaj amandman na član 14 koma 2 odnosi se pre svega na ovo da pristup ahriivskoj gradji imaju samo gradjani Kosova. Medjutim, ponavljam, sada neću ono da ne bi ste bili iritirani, da kažem: u preporuci Saveta Evrope se kaže ovako: – član 5. Pristup javnim arhivama je pravo u političkom sistemu koji poštuje demokratske vrednosti. Ovo pravo će se primenjivati na sve korisnike, bez obzira na nacionalnost, status ili funkciju. To je arhivistički princip, to je preporuka Saveta Evrope. Ja ne znam, nema razloga da ne bude prihvaćen ovaj amandman.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju lutem. Pas sqarimeve, unë po shoh se ka përkrahje edhe nga komisionet. Urdhëro për fjalë, zoti Çelaj. Qëndrimi i Komisionit është i qartë, pa përkrahje, por unë po pyes në qoftë se ndryshimi është vetëm në atë që informacioni në arkivë nuk mund, pos atyre që janë me vendime të veçanta dhe periudhë të caktuar, dhe nuk i lejon opinionit, nuk duhet të mbyllemi, mendimi im është dhe si deputet po flas.

LIRAK CELAJ:

Këtu është sqaruar me një nen tjetër dhe do të thotë sqarohet çasja e qytetarëve - shtetasve të huaj se si mund të qasen në arkivat, do të thotë me leje të ministrisë dhe janë disa procedura tjera që janë bërë në vazhdim të ligjit, kurse këtu, mendoj se vërejtja që është bërë nga Koalicioni "Kthimi" është term politik që është dashur t'i shmangen "qytetarët e Kosovës" dhe ta lënë vetëm qytetarët e interesuar që nënkupton edhe të Serbisë dhe të gjithë tjerët. Prandaj, ne iu kemi shmangur kësaj. Është nen i posaçëm që parasheh qasjen e shtetasve të huaj, prandaj nuk besoj se ka nevojë...

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Pas sqarimeve është e qartë, meqë me nen tjetër rregullohet. Dragisha Kërstoviq, shef i Grupit parlamentar.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poštovane kolege, ja se ne bih složio sa komentarom koji je dao prethodni kolega. Jednostavno postoji taj strah da građani Srbije ne dođu i da koriste arhivsku građu koja se nalazi na Kosovu i metohiji. Ali ovde se radi o jednom poboljšanju teksta ove odredbe i zaista se ne odnosi na građane Srbije posebno nego na sve zainteresovane građane. Znači ako već tako hoćemo, onda na građane Kosova i metohije i sve građane izvan Kosova i metohije i građane makedonije, i građane Albanije i građane nekih drugih... Mislim da zaista nema razloga da ta arhivska građa, koja inače ima tu funkciju da služi nekim opštim svetskim interesima, da bude korišćena na taj način zašto da ne.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Çelaj ishte shumë i qartë, ju lutem, meqë rregullohet me një amendament, me një nen tjetër.

Vë në deklarin amendamentin 13 – Grupi parlamentar “Kthimi”, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Vetëm 19 vota janë për, prandaj amendamenti nuk aprovohet.

Amendamenti 14, Grupi parlamentar “Kthimi” pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? 15 janë për.
Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 15 Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Nuk ka kundër.
A abstenon ndokush? 15 abstenime.

Amendamenti 16 Dy propozime të ndryshme:
a) Grupi parlamentar “Kthimi”, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore, dhe
b) Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për variantin a)? Urdhëroni ...

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Očigledno nećemo u Evropu, nažalost, nažalost! Moram opet da kažem, ovo što ja pričam odnosi se pre svega na preporuke Saveta Evrope u ovoj oblasti... Dobro... Ja vam kažem da je to to. Znam da ima ovde boljih stručnjaka od mene i trebali bi da se izjasne po tom pitanju. Član 17.tačka 4 piše: «Strane institucije kao i strani građani mogu koristiti arhivsku građu shodno konvencijama kao i po međunarodnim sporazumima na osnovu faktičkog reciprociteta; strani građani mogu koristiti arhivsku građu na osnovu odobrenja Uprave kosovskih arhiva». Znači šta, međunarodna javnost, međunarodno pravo ne poznaje konvencije po ovom pitanju. Samo ih izgleda mi izmišljamo. Možda smo izuzetak. Treba da se briše ovaj član.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Unë e kam për obligim fjalinë e fundit me prishë nga procesverbali dhe lus deputetët të mos ofendojnë, në veçanti, mbi baza etnike sepse është shumë e dëmshme dhe në këtë Parlament një vit e gjysmë nuk është lejuar dhe nuk do të lejohet. Ndërsa, shprehja e mendimit të lirë është e drejtë edhe individuale edhe Grupit parlamentar, prandaj pa ofendime – zoti Lubomir Stanojković.

Thash, kush është për variantin nën a) të Grupit parlamentar “Kthimi”. Mua më duhet ta vë në votim dhe le të kryhet procedura e nevojshme. 15 janë për. Prandaj, nuk miratohet.

Kush është për variantin b) Komisioni funksional dhe komisionet kryesore? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 9 vota kundër.

A abstenon kush? 3 abstenime.

Amendamenti 17, Grupi parlamentar “Kthimi” pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Urdhëroni për sqarime. E ka fjalën Lubomir Stanojković.

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Ovaj amandman se odnosi na član 17 pet i morate da slušate, mislim treba da me saslušate. U Nacrtu piše ovako «Arhivski autoritet rešenjem zabranjuje korišćenje arhivske građe na načinu po postupku i u periodu u kojem se povređuje bezbednost, javna bezbednost, preventivno delovanje, privatni život...» sad da ne idemo dalje. Međutim, ova formulacija je nastala izgleda na osnovu nacrtu preporuke Saveta ministara, Saveta Evrope, državama članica o dostupnosti službenih informacija. Međutim, ovo se odnosi na dokumenata koja su u posedu javnih vlasti a ne u posedu arhiva. To je pravo, to je prava istina. Ja mislim da ovo ne treba da egzistira kada su u pitanju arhive. Ovo se odnosi na dokumenta, mislim preporuka. Ovde već pokušavamo da znači koristimo preporuke Ministara Saveta Evrope. Ovo treba da se briše iz razloga zato što arhivistički princip ne poznaje ovakve zabrane nego samo dokumenta koja su u posedu vlasti.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, Stanojkoviq. Duhet të vazhdojmë me procedurë.

Kush është për amendamentin e "Kthimit" me sygjerimet dhe arsyetimet që i dha deputeti. 15 janë për. Nuk mriatohet amendamenti.

Amendamenti 18, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? 14 abstenime.

Amendamenti 19, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 1 kundër.

A abstenon ndokush? 14 abstenime.

Amendamenti 20, Grupi parlamentar PDK i përkrahur nga Komisioni funksional dhe Komisioni për buxhet, pa përkrahje nga Komisioni për komunitete.

SADUDIN BERISHA:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, ministra të rrespektuar,

Nëse kemi parasysh amendamentin paraprak të miratuar së themeluesi i Arkivit të Kosovës është Kuvendi i Kosovës, mendoj se amendamenti që është propozuar dhe mbështetur nga Grupi Parlamentar i PDK-ës dhe buxheti, pa përkrahjen e Komisionit për komunitete, nuk duhet të miratohet sepse në 21.1. në tekstin e Projektligjit, nëse kemi parasysh tekstin ekzistues, ministria është themeluese e arkivave ndërkomunale dhe kërkohet mendimi nga drejtorja e arkivave ndërkomunale dhe Kuvendi i Kosovës. Niveli i Kuvendit të Kosovës nuk duhet të shkojë në dy-tri shkallë. Ai është organ ligjvënës dhe nuk mund të japë mendim, përderisa ministria dhe në një mënyrë i legjitimon Kuvendi i Kosovës dhe propozoj që ky amendament të mos përkrahet.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Çelaj.

LIRAK ÇELAJ:

Unë dua ta arsyetoj qëndrimin e Komisionit për kulturë përse është pro dhe përkrahur. Nga se niveli ndërkomunal, domethënë, i përket ministrisë së kulturës si nivel, prandaj automatikisht është nivel qendror dhe në qoftë se është nivel qendror atëherë duhet të ketë kompetenca Kuvendi aty dhe siç është themelues i Arkivit të Kosovës dhe kjo pasi është nivel qendror duhet të jetë themelues kuvendi komunal, do të thotë Kuvendi i Kosovës, siç është themelues

kuvendi i komunës për ato komunale. Prandaj, për nivelin qendror pa marrë parasysh se si do të quhen, duhet të jetë themelues Kuvendi i Kosovës, kurse për ato të nivelit komunal duhet të jetë themelues kuvendi i komunës.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Urdhëroni...Mevlyde Saraçi.

MEVLYDE SARAÇI:

Zoti kryetar, unë pajtohem si anëtare e Komisionit me vërejtjen që tha përfaqësuesi i Komisionit për komunitete nga se deputetët e LDK-ës, që janë anëtarë në Komisionin për kulturë, rini dhe sport, nuk janë pajtuar. Kanë qenë kundër dhe përsëri jemi kundër këtij propozimi. Por, në udhëtim zyrtar që ka qenë zoti Sabit Rrahmani neve na ka munguar një votë, prandaj edhe ka ndodhë kështu. E kam obligim ta sqaroj të drejtën se deputetët e LDK-ës nuk përkrahin këtë amendament.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Urdhëroni... zonja Statofci...

DRITA STATOFCI:

Për hirë të mbarëvajtjes së punës, të stabilizimit të punës së arkivave, për hirë të avancimit të punës, të natyrshmërisë së punës së arkivave, për hirë të raporteve dhe marrëdhënieve në rrafshin e arkivave dhe organet themeluese e të tjera, dhe për hirë të asaj që ne pak më parë aprovuam amendamentin 21, ku themelues i Arkivit të Kosovës është Kuvendi i Kosovës, nuk mund të bijmë ndesh këtu dhe është e natyrshme që përsëri këtu të jetë amendamenti sikur që është propozuar. Prandaj ne nuk mund të jemi kundër vetëvetës por edhe kundër natyrës së punës dhe intencës që e kërkon natyra e punës së arkivave. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit zonja Statofci. Dua që kësaj radhe ta aprovojmë mendimi ne kolegut nga Kryesia, të Hydajet Hyseni dhe jam kundër Komisionit për buxhet dhe jam për Komisionin për komunitete. Prandaj, procedojmë.

Kush është për amendamentin 20, i lutem le të çojë dorën.

Ju lutem vetëm 24 vota janë për, prandaj nuk aprovet amendamenti.

Amendamenti 21, Grupi Parlamentar PDK, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Vetëm 12 vota për dhe nuk përkrahët amendamenti.

Amendamenti 22, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka kundër.
A abstenon ndokush? 8 abstenime.

Amendamenti 23, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon ndokush? 9 abstenime.

Amendamenti 24, Grupi Parlamentar "Kthimi" i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Komisionet kanë obligim atë që kanë votuar në komisione, të mos ngjajë ta ndryshojnë mendimin. Nuk bën kurrësesi. Numëroni votat ju lutem.

Kush është për? Falemnderit.
Kush është kundër? Janë 10 vota kundër.
Kush abstenon? 5 abstenime.

Amendamenti 25, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? 2 kundër.
A abstenon kush? 14 abstenime.

Amendamenti 26, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon ndokush? 15 abstenime.

Amendamenti 27, Grupi Parlamentar PDK, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe nga Komisioni për komunitete, i përkrahur nga Komisioni për buxhet.

Kush është për? 31 vota janë për.
Kush është kundër? 33 vota kundër.
A abstenon ndokush? 9 abstenime.
Nuk miratohet.

Amendamenti 28, Grupi Parlamentar "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Urdhëroni..

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Ovaj amandman Koalicije «Povratak» se odnosi na član 25., tačnije član 25.2 odnosno na sastav upravnog odbora i mi predlažemo da pored navedenih koji bi trebali da uđu u sastav Upravnog odbora Arhiva Kosova, trebalo bi da se ubaci i član ili predstavnik univerziteta u Kosovskoj Mitrovici, iz dva razloga: iz jednog razloga to je da jedini način da i neki Srbin bude član Upravnog odbora a drugi ako već po ovom predlogu treba da bude predstavnik Prištinskog univerziteta ja ne vidim razloga zašto ne bi bio i neki predstavnik Kosovsko-mitrovačkog univerziteta koji egzistira i de jure i de fakto.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit.

Kush është për këtë amendament? 16 vota janë për. Nuk miratohet.

Amendamenti 29, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? 11 abstenime.

Amendamenti 30, Komisioni funksional dhe Grupi Parlamentar PDK i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 15 abstenime.

Amendamenti 31, Dy propozime që ndërlihen në mes veti, dhe nëse ndërlihen mes veti nuk janë dy propozime. Thuhet Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe b) Grupi Parlamentar... Do të thotë është një propozim.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? 15 abstenime.

Amendamenti 32, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? 13 abstenime.

Amendamenti 33, Grupi parlamentar PDK, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon ndokush? 13 abstenime.

Amendamenti 34, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 13 abstenime.

Amendamenti 35, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Urdhëroni, doni të jepni sqarim.

SALA AHMETI:

Së pari ju përhëndes dhe kërkoj falje pse do të ndalem në disa çështje. Më vjen keq, por shpesh po ndodhë që amendamente të quhen edhe disa varianta gjuhësore ose korrigjime gjuhësore, të cilat do të duhej t'i bënte lektori. Ne nuk kemi ardhur këtu të bëjmë lekturë, por, edhe pse jam gjuhëtarë do të doja dhe do të mrekullohesha në qoftë se këto ligje na vijnë me një gjuhë të përsosur dhe pa fjalë të huaja dhe pa ndërtime e pa konstrakte të dëmshme. Mirëpo, edhe në Ligjin të cilin jemi duke miratuar kam nënvizuar shumë raste të tilla, të cilat nuk do t'i përmend. Për shembull, "person juridik" e tjera, "subjekt juridik". Këto janë çështje gjuhësore dhe ne këtu vazhdimisht po themi "aprovoi" e duhet të themi "miratoi" e tjera. Por, konkretisht te ky nen, amendamenti 35, thotë "dhe në përgjithësi", në vazhdim fjala "dhe" zëvendësohet me lidhësen "e". Lidhësja "e" dhe fjala "dhe" janë lidhëse që të dyja dhe janë lidhëse bashkërenditëse sinonimike, të cilat s'është e thënë ta zëvendësojnë njëra tjetrën. Madje, këtu shumë më mirë po tingëllon lidhësja "dhe". Shikojeni mirë. Domethënë, ju votoni cilindo, janë sinonimike.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Unë besoj që ju përkrahë tërë Parlamenti për këtë dhe s'kemi çka tjetër. Një pjesë e madhe e kohës po humbet me këtë. Prandaj duhet të procedojmë.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Një votë kundër.
A abstenon kush? Janë 13 abstenime.
Amendamenti aprovohet.

Amendamenti 36, Grupi parlamentar "Kthimi", i përkrahur nga komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.
A abstenon ndokush? Një abstenim.
Ju falemnderit.

Po e vërej se ka lodhje në Parlament. Ta përfundojmë këtë dhe ta bëjmë pastaj një pauzë. Ju lutem të vazhdojmë dhe të jemi sa më aktivë për këto çështje.

Amendamenti 37, Grupi parlamentar i PDK, pa përkrahje nga komisioni funksional dhe nga komisionet kryesore.

Urdhëroni.

DRITA STATOFCI

Vetëm një shpjegim, para se të votojmë, pa marrë parasysh cili variant do të fitojë. Këtu është fjala për ngritjen e punës, për ngirjtn e cilësisë së punës së arkivave dhe njëherit është fjala për dhënien e mundësisë të fitimit të titujve profesional dhe të titujve apo gradave shkencore. Nuk është mirë që aty ku kamundësi që ndokush, përveç titullit profesional, të ketë edhe tituj shkencor apo grada e të mos i gëzojë ato. Dhe ky amendament është pikërisht për këtë. Titujt arkivor janë tituj që mirren gjatë procesit të punës dhe tituj shkencor ose grada shkencore janë titujt që mirren gjatë shkollimit deri në shkallën superiore më të lartë akademike. Dhe mendoj se këtu nuk ka asgjë të keqe dhe asgjë që kundërshtojnë njëra-tjetrën, por që të dyja janë në favor të ngritjes së cilësisë, qoftë të punës, qoftë të titujve të punonjësve të arkivave. Prandaj unë mendoj se duhet të kemi konsideratë për këtë amendament.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dëgjuat arsyetimet. Prandaj, procedojmë.

Kush është për këtë propozim të amendamentit? 20 janë për.
Amendamenti nuk aprovohet.

Amendamenti 38, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër? Askush.
A abstenon ndokush? 10 vota abstenojnë.
Amendamenti miratohet.

Amendamenti 39, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush? 12 abstenime.
Amendamenti miratohet.

Amendamenti 40, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 12 abstenime.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 41, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një kundër.

A abstenon ndokush? 13 abstenime.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 42, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 12 abstenime.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 43, Grupi Parlamentar PDK, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni për komunitete, i përkrahur nga Komisioni për buxhet.

Doni të sqaroni. Urdhëroni...

SADUDIN BERISHA:

I nderuari kryetar, amendamenti 43 s' duhet fare të qitet në votim, dhe si amendament s' duhet të ekzistojë nga se ky Kuvend, me procedurë të rregulltë, ka aprovuar nenin 7.5 deri 27.1 dhe gjërat kanë ecur përpara. Sikur të miratohet ky amendament krejt koncepti i Projektligjit do të ndryshojë. Prandaj ky duhet të hudhet si amendament i paqenë ose i paekzistuar.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. A ka kush ndonjë sqarim tjetër plotësues?

Nëse s'ka atëher, vë në votim amendamentin e Grupit Parlamentar të PDK-ës dhe të Komisioni për buxhet.

Kush është për këtë propozim, i lutem le të çojë dorën. Vetëm 15 vota për. Ju falemnderit. Prandaj propozimi i amendamentit nuk miratohet.

Tani duhet ta votojmë Ligjin në tërësi.

Kush është për këtë Ligj, me amendamentet e propozuara. Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 vota kundër.

Kush abstenon? Askush.

Prandaj, konsideroj se Ligji është aprovuar në Parlament. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For	Shumica – Vecina – Majority.....
Kundër – Protiv – Against	13
Abstenuan – Uzdržanih – Abstained	00

Tani do të bëjmë një pauzë njëorëshe.

(VIJON PAUZA)

* * * * *

PAS PAUZËS SEANCA VAZHDOI PUNËN

**SEANCËN VAZHDOI TA KRYESOJË BASHKËKRYESUESI SABRI HAMITI,
ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT**

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën e seancës.

Në radhë kemi pikën e tretë të rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë. Ky është një Projektligj që është miratuar në parim më 27 mars 2003 dhe që ka kaluar nëpër komisionet përkatëse dhe përpara kemi amendamentet të cilat kanë kaluar nëpër të gjitha instancat paraprake në Parlament.

Për fillim, nëse ndokush nga komisionet ka të thotë diçka të veçantë, mund ta marrë fjalën në mënyrë që të kalojmë menjëherë në shqyrtim prej neni në nen. E ka fjalën ministri Ali Sadriu.

ALI SADRIU:

E nderuar Kryesi, i nderuar kryesues, të nderuar deputetë,

Ju para veti, ndër të tjera, kemi edhe një amendament të dërguar nga Qeveria. Kështu ju figuron në material dhe unë jam këtu për t'ju sqaruar se ai amendament nuk është i Qeverisë. Është dërguar nga një ministri dhe e kemi shqyrtuar dje dhe jemi marrë vesh në Qeveri dhe këtë që ua them tani është vendim i Qeverisë, që ai amendament tërhiqet.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit zoti ministër. Fjalën e ka përfaqësuesi i “Kthimit”.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poštovani predsedavajući, poštovane kolegenice i kolege poslanici, Ja ću još jednom da učinim jedan apel da pokušamo da dobro razmislimo i da dobro shvatimo svoju ulogu i svoju funkciju kod razmatranja i ovog Nacrta zakona i svih amandmana koji su na Nacrt zakona došli. Zaista mislim da se radi o jednom ozbiljnom zakonskom tekstu, o jedno vrlo važnom zakonu i mislim da bi smo morali da povedemo računa kod izjašnjavanja o zakonu i amandmanima koji su pristigli na tekst ovoga Nacrta.

Ja još jednom želim da skrenem pažnju, posebno na odredbe člana 18. i člana 19. Nacrta zakona i ne bi bilo nimalo dobro da se posle izvesnog vremena ovako nadjemo u situaciji da kažemo e pa zaista je trebalo dobro da otvorimo oči kada smo usvajali ovaj Zakon.

Koalicija «Povratak» nije imala amandmane ali u principu će biti protiv ovog Zakona. Mi smo se protiv izjasnili i onda kada je bilo prvo čitanje Zakona tako da to je to. Dakle, Zakon je ozbiljan, njegove odredbe zadiru u imovinu građana Kosova i zato bi dobro trebalo da se razmisli prilikom odlučivanja i o Zakonu i o amandmanima koji su na Zakon podneseni. Hvala.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Le të urdhërojnë anëtarët e komisioneve.

MILOVAN JOVANOVIĆ:

Poštovano Predsedništvo, poštovane kolege, Član 18., famozni član 18. izražava suštinu ovog Zakona. Šta je u njemu bitno? Kaže ovako "opština može dostaviti obaveštenje o oduzimanju". Kako se može oduzimati imovina obaveštenjem. Ja ne znam u nekom pravnom sistemu da to postoji, gde se opština bavi kao izvršni organ lokalne samouprave oduzimanjem imovine. Mislim da je to potpuna besmislica.

Dalje, tek u stavu 18.3 vodi se sud. Pa sud je ta treća instanca koja omogućava i nekoj stranci koja je oštećena da se valjda po nekoj proceduri žali i da se na vagu stave argumenti za i protiv. Znači tek na kraju člana sud se vodi. To je neprihvatljivo.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Zoti deputet, ne nuk kemi filluar të diskutojmë amandmane. Ju lutem shumë, kur të vjen amendamenti 18 dhe neni, ju mund ta merrni fjalën. Tash ne nuk jemi ardhur deri aty.

MILOVAN JOVANOVIĆ:

Znači, da izrazim jedno mišljenje sintetičko Komisije, kao član Komisije. Član 18. izražava suštinu ovog Zakona. On je duboko anticivilizacijski, ugrožava osnovna ljudska prava, ne samo Srpske zajednice nego svih građana Kosova. U to bi smo se uverili ukoliko ovaj Zakon

bude u operativnoj primeni, uverili bi se svi gradjani, siguran sam u to i mislim da bi trebalo vratiti predlagaču ovaj zakon na doradu tako da bi, tako da bi, onda taj član mogao biti prihvatljiv. Inače, ovakav kakav je, neprihvatljiv je. Mislimo da je anticivilizacijski, nedemokratski apsolutno.

Još jednu stvar poslanika AAK, gospodin Bajram Kosumi, je na prvom čitanju Nacrta zakona to dobro primetio. Medjutim, vidim da to više kod tih parlamentarnih grupa ne prolazi i oni ne daju više podršku takvom njegovom stavu. Toliko, hvala.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

T'falemnderit. Unë nuk shoh që ka ndokush tjetër që do të bisedojë tutje dhe para se të nisim. Ne do të fillojmë me shqyrtimin e amendamentit...Nëse, është thelbësor, urdhëroni...

BAJRAM KOSUMI:

Kolegu im i mëparshëm ka të drejtë neni 18 është çështje thelbësore këtu dhe ne kemi ngritur këtë çështje, e kemi diskutuar dhe është amendamenti, tash nuk e di cili me radhë, por është amendament i cili definojnë pronën e domosdoshme për banim, e cila, sipas një mesatarjeje të standardit në Evropë është 20 metra katrorë për kokë banori për qytetarë. Dhe, kjo është ajo prona të cilën nuk mund as komuna, as gjyqi, dhe askush tjetër ta qesë në shitje për shkak të borxhit që ka tatimpaguesi. Pjesa tjetër, është pjesë e procedurës. Do të thotë është një përmirësim aty që është bërë dhe mendoj se amendamenti i plotëson kërkesat.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. Po fillojmë me shqyrtimin e amendamenteve.

Amendamenti 1, I paraqitur nga deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Ju lus, kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Kundër 14.

Le të numërohen votat ju lutem. Ndonëse në princip "Kthimi" thotë se s' do ta votojmë ligjin, kështu që mundeni edhe ta dini menjëherë, por sido që të jetë, numëroni.

Kush abstenon? Nuk ka abstenime.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje të komisioneve kryesore.

Ju lutem, kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 14 kundër.

Kush abstenon? Nuk ka abstenime.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3, Thotë Qeveria me përkrahje nga komisionet kryesore. Për këtë, Qeveria tha se bjen. Amendamenti 3 përkrahet nga komisionet kryesore.

Kush është për? 31 për.

Kush është kundër? 16 kundër.

A abstenon kush? Askush.

Amendamenti 3 miratohet.

Amendamenti u votua, s'ka sqarime më. Çfarë doni të sqaroni?

GANI PREKOPUCA:

Një moment. Komisioni për buxhet është i sabotuar. Këtu dëgjuam prej Qeverisë se ky amendament nuk ka ardhur prej Qeverisë. Dikush na e ka futur. Ne kemi votuar duke menduar se është i Qeverisë, prandaj kërkoj që ky amendament të anulohet. Do të thotë nuk ka qenë i Qeverisë kurse ka ardhur në emër të Qeverisë. Prandaj, është i sabotuar, për mua.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ne dëgjuam mendimin e deputetit, mirëpo unë qartë e thash e këtë edhe ministri në fillim. Ky del si amendament që propozohet nga Qeveria me përkrahje nga komisionet kryesore. Kjo i bje se tri komisione e kanë përkrahur dhe e qita në votim, votuat si votuat, shkojmë tutje. Urdhëro, çfarë do të sqarosh.

ALI SADRIU:

Deputetë të nderuar, unë nuk desha të elaboroj më shumë pos asaj që thash se ai amendament nuk është i Qeverisë. Atë amendament e ka çue Ministria e Shërbimeve Publike dhe në vërejtjen që ka dhënë Sekretaria juaj, e ka kthyer dhe e ka prurë në emër të Qeverisë. Qeveria ka debatuar dhe e ka hudhur poshtë. Ka shumë arsye pse. Norma e tatimit 0,5 deri 2, dyshi është plafoni. Kërkush nuk e obligon kuvendin komunal të shkojë me 0,6, 0,7. Qeveria nuk ka dhënë amendament tjetër, ju lutem. Prandaj nuk është dashur të figurojë se Qeveria e përkrahë këtë amendament.

Amendamenti 4, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Ju lutem, kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 15 janë kundër.

Kush abstenon? 2 abstenime.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Ju lus, kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 14 kundër.

A abstenon kush? 2 abstenime.
Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Ju lus, kush është për amendamentin? Ju falemnderit.
Kush është kundër? 14 kundër.
Kush abstenon? Nuk ka abstenime.
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7, Komisioni për buxhet, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? 14 kundër.
A abstenon ndokush? 3 abstenime.
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8, Kemi dy propozime, që kërkojnë sqarime.
- Komisioni për buxhet, me përkrahje nga Komisioni funksional, dhe
- Qeveria dhe deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje të pjesërishme nga Komisioni për buxhet.

Unë dëshiroj që të sqarohen të dy rastet. Komisioni për buxhet thotë në përkrahje të njëres variantë, dhe pastaj Komisioni për buxhet përkrahje të pjesërishme. Ju lutem, shefi i Komisionit për buxhet le ta sqarojë, sepse s'mundeni dyfishë ju ta përkrahni dikënd.

HAKI SHATRI:

I nderuar zoti kryesues, këtu nuk është fjala për ndonjë kundërshtim të propozimeve por zonja Dauti ka propozuar që kufiri i epërm prej 2% të zbritet në 1% dhe ai propozim është përkrahur nga Komisioni për buxhet. Në të njëjtën kohë, Komisioni për buxhet ka dalë me propozim të ri që kufiri i poshtëm 0.05% të zbritet në 0.02%. Prandaj të dy propozimet mund të përkrahen dhe nuk janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Sa për sqarim t'ju them se propozimi i Komisionit për buxhet të kufirit të poshtëm, që të ulet, ka të bëjë vetëm me kategorinë e pronave djerrina, sepse në Projektligj ka qenë propozuar që tokat djerrinë të lirohen fare nga tatimi në pronë. Kurse, Komisioni për buxhet ka propozuar që të ulet kjo dhe ka të bëjë vetëm me tokat e papunueshme. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Këtu mund të sqaroni, Nerxhivane, por kjo është shumë e qartë dhe këtu ka dallime, sepse kufiri i poshtëm dallon.

NERXHIVANE DAUTI:

I nderuari zoti kryesues, propozimi për shkallën 0.05% dhe 1% kanë të bëjnë me 4 kategoritë e pronës, të cilat janë në Projektligj. Ndërsa, kemi amendamentin e veçantë me propozim të shkallës prej 0.02 nga Komisioni për buxhet dhe ekonomi e financa. Ky amendament është i veçantë dhe i referohet nenit 6.2 nën e). Ky është sqarimi.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. Dëgjuat dy shpjegimet e dy propozuesve. Ne tash për tash kemi këto alternativa dhe do t'i votojmë qysh i kemi, sepse metodë tjetër në këtë fazë nuk ka.

(Nga Kryesia e punës: Nëse është 6.2 e) atëherë është për tjetër kategori, domethënë nuk janë kontradiktore njëra me tjetrën)

Tjetër kategori po, por ky është gjend në këtë vend. Ne duhet ta heqim nga këtu dhe ta votojmë tjetërkund, nëse nuk kemi ariantë tjetër të votimit të ligjit.

Vë në votim varianten e amendamentit 8 dhe atë varianti:

- a) Komisioni për buxhet, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për, ju lutem le ta ngrisë dorën?

Urdhëroni, por sqarimet le të bëhen me kohë ju lutem.

BESA GAXHERRI:

Zoti kryesues, zonja Nerxhivane sqaroi shumë mirë. Unë vetëm dola ta përforcoj mendimin e saj. Domethënë, prej kater kategorive që tashmë janë, e para, e dyta, e treta, e katërta, është e përcaktuar dhe ne jemi pajtuar me 0.5% deri në 1% Komisioni për buxhet, ndërsa kategorinë për tokat djerrë, të lëna pasdore kemi formuluar amendamentin e veçantë që do ta ketë 0.02% tatimin. Domethënë, unë propozoj që ta votojmë amendamentin e zonjës Nerxhivane e pastaj të vijmë te neni 6, a po. Te neni 6. pika e) është amendament i veçantë. Ma merr mendja se është e qartë.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Deri diku. Urdhëroni, edhe një herë ministri i resorit do të marrë fjalën.

ALI SADRIU:

Mua, më vjen keq, kolegë të nderuar që duhet për të tretën herë të dalë këtu. T'ju njoftoj se ky Ligj është përshkrim i rregullores që zbatohet që një vit nga a deri në zh. Nuk e kemi bërë rastësisht. Pra se të miratohet ajo rregullore, në Kosovë ka patur një pilotprogram që ka operuar për një vit dhe ka patur modalitete – komuna të mëdha, të mesme dhe të vogla. Këto norma janë hulumtuar gjatë nga ekspertë ndërkombëtar dhe lokal. Unë thash, nga 0,5 deri në 2. Dy është tavani. Po e përsëris, nuk e pengon kërkush kuvendin komunal të mos e merr as 1, por ta merr 0,6 ose 0,7, ose 0,5. Unë sygjeroj dhe ju lus, sepse mendoj e njoh këtë problematikë dhe di prapaskenat e kurdisura që ky ligj një ditë të mos nënshkruhet dhe t'i miratoni këto norma kështu si janë. Është e ngjashme me tatimin mbi pronën. Ju kujtohet çfarë polemika ka patur dhe nuk do të doja të elaboroj më gjatë, por besoj se jeni duke më kuptuar të gjithë. Do të thotë është çështje e kuvendeve komunale, nëse figuron 2, ai mos të shkoi as 1, por le të figurojë kështu siç është. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Unë kam rekomandimet dhe raportet e Komisionit, amendamenti 2, e kanë këtu dhe thotë: neni 6.1 shkalla e tatimit në mes 0,05% dhe 2% të zëvendësohet me 0,2. Dhe kjo është çka është. Njëshi është këtu dhe këtë njësh që del këtu tash del në dy variantat dhe në propozim, zotëri nuk e keni. Jo, këto dy nene nuk janë... E njëjta materie është por janë dy varianta. Nuk janë dy nene. Janë dy varianta dhe s'mbetet kurgjë tjetër, por t'ju them:

Nën a) – Kush është për variantin e Komisionit për buxhet, me përkrahje nga Komisioni funksional, ju lutem le ta çojë dorën. Për janë 24.

Kush është kundër? Kundër 24.

Kush abstenon? Abstenime 12.

Në këtë rast, sipas rregullave të punës së Parlamentit tonë dhe të Komisionit, rezultati baraz 24 me 24 bëhet inekzistent sepse as s'miratohet as s'hudhet dhe mbetet kurgjë hiq.

Nën b) Qeveria dhe deputetja Nerxhivane Dauti, t'hamë bjen Qeveria se e keni bërë ju, me përkrahje të pjesërishme nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për këtë variantë? 47 për.

Kush është kundër? 5 kundër.

A abstenon ndokush? 5 abstenime.

Amendamenti, nën variantën b) miratohet.

Po, u votua, s'ka më çfarë të flitet. Urdhëroni...

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Dakle, ja ozbiljno stavljam ozbiljnu primedbu na način glasanja i proglašavanja da je neki amandman usvojen odnosno da nije usvojen. Nijedan amandman ne može biti usvojen ako za

njega ne glasa najmanje 61 prisutni poslanik. Ja ne kažem koliko treba ovde da bude prisutno, ali 61 poslanik mora glasati za.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Të falemnderit. Ne normalisht i japim mundësi deputetit që ta japë mendimin e vet dhe vazhdojmë më tutje.

Amendamenti 9,

Ka dy propozime të ndryshme:

- a) Komisioni për çështje gjyqësore, legjisllacin dhe kornizë kushtetuese, me përkrahje nga komisionet kryesore, dhe varianti i dytë,
- b) Deputetja Nerxhivane Dauti me përkrahje nga Komisionet kryesore.

Ju lutem dëgjoni mirë, mos krijoni pastaj konfuzione. Shpjegime, nëse ka nevojë i jipni. Këto komisionet kryesore s'kanë bërë asgjë por i kanë përkrahur të dy anët dhe le të definohen të cilin e kanë përkrahë. Ju lutem nga komisionet kryesore të dilni të sqaroni çfarë përkrahni. Me këtë do të thotë se nëse a) miratohet, b) s'ka objekt shqyrtimi.

SADUDIN BERISHA:

I nderuar kryesues, Komisioni për komunitete ka shqyrtuar Projektligjin mbi tatimin në pronë dhe ka konstatuar se interesat e asnjërit prej komuniteteve nuk cenohen dhe nuk ka shqyrtuar fare amendamentet me vetë konstatimin se nuk cenon interesat e komuniteteve. Kështu, nuk qëndron a ty m bështetja e dhe Komisionit të komuniteteve ndaj amendamenteve të njërit apo grupit tjetër. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Të falemnderit. Kërkoj mendimin e komisionit tjetër çfarë mendon.

HAKI SHATRI:

Të falemnderit zoti kryesues. Unë kujtoj se kjo nuk është shumë e koklavitur sa ne po mendojmë se është, o se ndoshta, me keqardhje po them, nuk po përcjellim fort materien të cilën po e shqyrtojmë. Këtu është propozuar prej Komisionit për çështje gjyqësore të shtohet amendamenti i ri dhe është përkrahur. Kurse, amendamenti ekzistues të bëhet amendamenti ose paragrafi me radhë. Në të njëjtën kohë, deputetja Dauti ka propozuar që në paragrafin ekzistues të bëhet një riformulim i cili në përmbajtje nuk ka prekur ndonjë çështje buxhetore dhe ne si të tillë kemi thënë se nuk kemi kurgjë kundër, është vetëm një shprehje e thënë kështu ose në ndonjë formë tjetër. Prandaj, le të urdhërojnë deputetët ta votojnë këtë ose atë. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Të falemnderit. Vë në votim variantin a) Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Nerxhivane, u sqarua kjo. Urdhëro, por s'ke qa lehtëson se i kemi dy variante dhe ne do t'i votojmë ato.

NERXHIVANE DAUTI:

Dy propozimet janë të përkrahura nga komisionet kryesore. Të dyja janë në përputhje dhe nuk janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Prandaj, nuk ka nevojë që të votohen dy herë por me të njëjtin akt të votohet një herë.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Po pse i keni propozuar të dyjat. Varianti i tekstit i studiuar thotë që përafërsisht edhe teksti, materia e zonjës Dauti ekziston në ariantin më të zgjeruar të variantit a) prandaj unë s'kam rrugë tjetër pos ta vë në votim variantin nën a) të Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese me përkrahje të komisioneve kryesore.

Ju lutem, kush është për këtë propozim, i lutem le të çojë dorën. Ju falemnderit.

Kush është kundër? 14 kundër.

A abstenon ndokush? 6 abstenime.

Është miratuar amendamenti 9 nën ariantin a), ndërsa varianti b) u tha se në këtë rast është i paobjekt dhe s'do ta votojmë.

Amendamenti 10, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? 2 abstenime.

Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 11 kundër.

Kush abstenon? 2 abstenime.

Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, me përkrahje nga komisionet kryesore dhe pa përkrahje nga Komisioni funksional.

BESA GAXHERRI:

Të nderuar deputetë, para se të kalojmë në nenin 8, unë ju lus përkundër punës së madhe të komisioneve, atij funksional dhe atyre të obligueshëm dhe zonjës Nerxhivane, na ka shpëtuar një amendament. Në nenin 7, ku bëhet fjalë për pronat e përjashtuara nga tatimi, nëse keni ligjin përpara lexoni. Unë kam bërë amendamentin nën pikën f), mos t'ua lexoj tani të gjitha pikat, domethënë nën pikën f) propozoj që të lirohen nga tatimi pronat e institucioneve fetare që shfrytëzohen si objekt kulturi. Ju lutem, nën këtë nen, është 7.2, shkruan "përjashtimet në nenin 7.1 nuk vlejné nëse prona shfrytëzohet apo mbahet për shfrytëzim për aktivitete komerciale ose për krijimin e të ardhurave. Domethënë nuk kërkojmë të lirohen nga tatimi pronat jashtë atyre institucioneve, por vetëm faltoreve. Kërkoj që deputetët ta përkrahin këtë amendament sepse kjo është e lejuar edhe me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/23. Kërkoj prej jush, sepse ligji mundet me u kthye e mos të nënshkruhet vetëm për shkak të këtij amendamenti.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. Urdhëroni Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

Besoj më merrni me mend, unë përsëri me vërejtje procedurale. Dua ta ritheksoj se për fat të keq, përsëri po na imponohet e njëjta praktikë. Komisioni për çështje legislative dhe kornizë kushtetuese bën amendamente që s'kanë të bëjnë me fushëveprimin e tij. Të mos e lexoj kompetencën e Komisionit për do t'ju lusja që ta lexoni dhe ta keni parasysh. Prandaj, le të rrespektojmë procedurën e shqyrtimit dhe hartimit të amendamenteve në Kuvend edhe në të ardhmen. Prandaj, unë propozoj që në përputhje me atë që thash edhe në fillim të kësaj seance sot, të njëjtën procedurë ta ndjekim edhe me propozimet e amendamenteve të Komisionit për çështje legislative dhe kornizë kushtetuese. Kurse sa i përket propozimet të deputetës, mendoj, megjithë rrespektin, ka një procedurë se si bëhen amendamentet. Amendamentet duhet pastaj të shqyrtohen edhe nga komisionet që janë përshkruar në rregullore dhe ne duhet ta rrespektojmë atë. Nëse ka arsye madhore për një gjë të tillë, atëherë le të krijohen mundësitë që kjo të bëhet në të ardhmen, por nuk mund thjeshtë ad hok këtu të aprovojmë amendamente. Le të kihet parasysh edhe dinjiteti i institucionit në të cilin bëjmë pjesë. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. Ne dëgjuam një propozim amendament. Natyrisht se proceduralisht është i vonshëm. Komisionet pse nuk e kanë propozuar me kohë, le të mendojnë vetë. Mund ta bëjmë propozimin edhe më vonë sipas rregullores me kohë të caktuar dhe ai do të vijë në shqyrtim. Ne morëm këtë në dijeni por rregullat nuk lejojnë që sot të votohet për amendamentin që nxirret në këtë fazë kështu. Dhe, vazhdojmë më tutje.

Amendamenti 12, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Urdhëroni, Hasan...

HASAN META:

Zoti kryesues, unë mendoj se ende s'e kemi kryer punën me këtë Projektligj dhe ky propozim, amendamenti është dorëzuar, si ka bredhur ai e çka është bërë nuk dihet por ky propozim duhet të hyjë patjetër në mënyrë që vërtetë të lejohen të mos paguajnë tatim ato objekte fetare që përdoren, siç e tha zonja. Mos të gabojmë që të na ndryshohet pastaj e të kemi procedura shtesë sa jemi këtu. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Me nderë qofshit. Urdhëroni, Kosumi...

BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit. E kam fjalën te amendamenti 12 që është duke u përgatitur për votim. Veç kthene pak prapa amendamentin 9 që e kemi votuar nën a). Ne e votuam dhe miratuam çka është prona e domosdoshme për banim, e votuam këtë. Në amendamentin 12.8.1 definohet sa është hapësira e pronës së domosdoshme për banim – 20 metra katror. Në amendamentin që do të vijë më vonë 21, definohet ajo që u tha në fillim të ligjit se çka nuk guxon të shitet, çka komuna nuk guxon t'i marrë qytetarit. Këto tri amendamente janë të lidhura në mes veti. Komisioni për legjislacion i ka propozuar, janë të miratuara nga komisionet kryesore dhe nuk dihet pse Komisioni funksional nuk i ka përkrahë. Është mirë të sqarohet pse s'i ka përkrahë. Mirëpo, me këto amendamente i pamundësohet gjyqit ose komunës që t'i qesë familjet dhe qytetarët në rrugë për shkak të borxhit që ka ndaj komunës. Mund t'ia shesë oborrin, garazhin, veturën, arat, fabrikat por shtëpinë të domosdoshme për banim nuk mund t'ia shesë. Në Projektligj si është, do të mund t'ia shesë edhe shtëpinë dhe me qitë në rrugë. Prandja, unë kërkoj që Komisioni funksional, nuk dihet cili është, por është mirë me sqaruar pse s'e ka përkrahur këtë amendament dhe ju ftoj ta votoni sepse përndryshe është shkelje e drejtave elementare të njeriut.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Urdhëroni Fatmir.

FATMIR REXHEPI:

I nderuar kryesues, rendi ka qenë të dalë kryetari i Komisionit për ekonomi e financa ta sqarojë këtë por ai abstenon. Prandaj, unë po them këtë. Komisioni funksional për ekonomi e financa me këto gabime çfarë janë bërë tash në tekstin që është ofruar, ka përkrahur do të thotë pjesën e parë 8.1 që ka propozuar Komisioni për çështje gjyqësore, ndërsa nuk ka përkrahë pjesën e dytë 8.2 që janë bashkë tani pjesë e këtij amendamenti në shumën prej 15.000 që të hiqen nga vlera e pronës, por e ka përkrahur ashtu sikur ka qenë në Projektligj. Ky është dallimi do të thotë. Ajo është tjetër çështje... duhet të sqarohet, sepse pjesën e parë e kemi përkrahë, pjesën e

dytë jo dhe këto janë arsye të shumta pse nuk është përkrahur nga Komisioni funksional për ekonomi e financa, sepse është shumë e madhe dhe po t'a merrni edhe të parën, domethënë me heqje edhe ato 20 metra katror por edhe çështjet tjera më herët që u biseduan, është tepër.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Unë nuk shoh diçka tjetër këtu, por e nxjerr në votim.

Kush është për propozimin e amendamentit 12? Shumica, ju falemnderit.

Kush është kundër? 14 kundër.

A abstenon kush? 12 abstenime.

Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13, Këtu edhe një herë Qeveria. Pa përkrahje nga Komisioni për buxhet. Këtu s'ke çka voton. Është inekzistent amendamenti 13.

Amendamenti 14, Komisioni për buxhet me përkrahje nga Komisioni për komunitete dhe Komisioni funksional.

Ju lutem, kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 11 kundër.

A abstenon ndokush? 3 abstenime.

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Ju lutem, kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? 1 abstenim.

Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit. Shumica.

A ka kush kundër? 14 kundër.

A abstenon ndokush? S'ka abstenim.

Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17, Qeveria me përkrahje nga komisionet kryesore...

Ky s'ekziston. Çfarë përkrahin komisionet nëse s'ekziston propozimi. Ju lutem kryetarët e komisioneve le të dalin dhe të referojnë.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju përshëndes të gjithëve. Unë mendoj kështu, nëse Qeveria nuk ka përkrahë, sponsorues i këtij amendamenti është Ministria për shërbime publike dhe ne kemi shqyrtuar si amendament që e kanë propozuar ata dhe gjitha komisionet kemi ardhur në përfundim se është në rregull. Ne disa, që ka sponsoruar kjo Ministri, i kemi hudhur si Komision dhe këto i kemi aprovuar. Nëse vërtetë tani jemi në baza profesionale dhe kemi gjykuar, pavarësisht nga kush është ardhë, ne kemi aprovuar dhe mendoj se është krejt në rregull dhe kurgjë nuk është keq kjo që është aprovuar. Le të mbetet e shërbimeve publike. Komisionet janë bazuar në amendamentet e shërbimeve publike. Sinqerisht, kemi debatuar shumë gjatë për këto çështje dhe kemi thënë se janë mirë e tash çka po doni me thënë – s'janë mirë dhe kushdoqoftë i ka propozuar ato. Tash po biem në kundërshtim me vetëveten në aspektin profesional. Mendoj se për mua është pak edhe qesharake kjo, por ne jse si të doni...

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Pse qesharake? Qesharake, nëse keni punuar qesharakisht, është. Përndryshe jo. Çdo amendament, zotëri duhet ta ketë propozuesin. Propozuesi i parë u bë inekzistent me dëshmi të Qeverisë këtu. Unë po dua të jam racional në punë dhe po them – ju thuani janë propozime të komisioneve, ne i votojmë. Urdhëroni, ju nga Komisioni tjetër, zoti Shatri.

HAKI SHATRI:

Ju falemnderit zoti kryesues. Komisioni për buxhet ka marrë amendamentet, të cilat në faqën e parë e kanë marrë një shkresë, sikur që është ajo preambula e Qeverisë dhe ka qenë e protokoluuar në zyrat e shërbimeve këtu në Kuvend. Edhe i ka shqyrtuar ato duke menduar se propozues është vërtetë Qeveria. Gjatë ditës së djeshme, në punën në Komisionin për ekonomi dhe financa, kemi kuptuar, domethënë kemi marrë informacion se ai nuk është propozim i Qeverisë por në një formë është m'askuar në shkresën përcjellëse të Qeverisë pa qenë real amendamentet e qeverisë dhe janë munduar në atë formë të na mashtrojnë... Amendamentet janë amendamente të Ministrisë për shërbime publike, por në letër përcjellëse thuhet se janë amendamente të Qeverisë dhe në fakt nuk kishin qenë amendamente të Qeverisë dhe unë nuk dija ka të drejtë Ministria e shërbimeve publike...Kështu është në letër përcjellëse me shkresë, ju lutem. Nga kjo prizëm e problemit, unë si kryetar i Komisionit për buxhet, propozoj që të gjitha amendamentet, edhe në qoftë se përmbajtja eventualisht ka mund të jetë e përkrahshme të hiqet sepse na hoqëm këtu amendament që po dijmë fort mirë proceduesin dhe e refuzuam për shkak të procedurës dhe tash propozoj që të gjitha amendamentet që janë të propozuara nga Qeveria të hiqen nga procedura e miratimit. Ju falemnderit.

GANI KOCI:

Nga diskutimet e zotit ministër të financave, por edhe nga diskutimet e deputetëve, erdhëm në dilemë se sikur të gjitha komisionet dhe të gjithë ne deputetët jemi në lajthitje të disa propozimeve të amendamenteve. Zoti ministër thotë se propozimet nuk janë të Qeverisë dhe zoti ministër nuk na dha asnjë fakt dhe asnjë letër përpos deklaratimit gojor se këto nuk janë të Qeverisë. Ndërsa, ne kemi para vetes propozimet që janë bërë në emër të Qeverisë nëpërmjet

Ministritë së shërbimeve publike. Derisa nuk kemi dokument tjetër nga Qeveria që i mohon se nuk janë të Qeverisë këto, për neve janë të arsyeshme dhe duhet të votojmë për këto amendamente të Qeverisë. Ne mund t'i hudhim por ne duhet t'i vendosim në amendamente.

Desha vetëm një sqarim, për ju zotri deputetë, që sikur po ngatërrohem ne dhe sikur po anojmë andej kah e kemi ministrin ose kryeministrin e të tjera. Unë nuk di, nëse mundet Ministria e financave të caktojë tatim mbi pronën nëse ajo ministri nuk bashkëpunon me zyrën kadastrale që mban bazën e të gjitha të dhënave mbi pronën. Dhe propozimi është ky: baza e të dhënave të tatimit mbi pronën duhet të bazohet në regjistrin e të drejtave mbi pronën. Prandaj, nuk shoh se ky propozim pavarësisht ka ardhur legalisht ose ilegalisht nga ky ministër ose nga kryeministri që bie ndesh dhe në kundërshtim me kërkesën dhe nevojën se duhet një bashkëpunim dhe një bashkërenditje për caktimin e tatimit në mes minsitrisë së financave, në mes ministritë së shërbimeve publike nëpërmjet agjencionit kadastral. Kjo është e tëra, prandaj zoti ministër na e depononi ju dëshminë me nënshkrim të kryeministrit se nuk janë këto të Qeverisë.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Urdhëroni zoti ministër.

ALI SADRIU:

Ju falemnderit zoti kryesues. Duhet ta sqaroj formën se si këto procese rrjedhin deri sa të vijjnë para këtij auditoriumi. Ministria gjegjëse e lëmisë gjegjëse është hartuese e draftligjit. I njëjti shkon në Qeveri. Qeveria jep miratimin që të përpunohet nen për nen dhe në seancën tjetër të qeverisë hartuesi prezenton bashkë me materialin ku kanë marrë pjesë të gjitha ministrinë edhe zyra e kryeministrit dhe materiali finalizohet si material i Qeverisë. Të gjitha këto procedura edhe ky Ligj i ka kaluar. Qeveria nuk ka të drejtë, në fund të fundit, me dhënë amendamente. Unë nuk di kush e ka çpikë, unë nuk jam jurist. Qeveria është ajo që jep draftligjin dhe pse të japë amendament. Këto janë gjëra thelbësore që juristat duhet të reagojnë këtu. Në rastin konkret, është miratuar në Qeveri drafti të cilin e ka dhënë si propozim Qeveria pa asnjë amendament.

Unë jam njoftuar vetëm për një amendament dhe në ndërkohë kur pash në material se ka shumë, kam kërkuar sqarimin në Qeveri se nga këto. Kjo ka ndodhë dje dhe ka qenë habi e të gjithëve, edhe e kryeministrit edhe e ministrave tjerë, ja këtu janë edhe dy ministra, dhe më në fund del se ato propozime janë dhënë nga Ministria për shërbime publike. Ne të gjithë po mësohemi, dhe mund të gabojmë, janë institucione të reja dhe u morëm vesh që parimisht të gjitha ato amendamente që janë dhënë në emër të Qeverisë të tërhiqen sepse nuk ka logjikë të shkojë në formën e tillë. Komisionet janë ato që mund të bëjnë amendamente dhe krejt në rregull dhe ne i absorbojmë të gjitha ato.

Prandaj, nuk ka pasë të drejtë Minsitria e shërbimeve publike apo Qeveria të bëjë amendamente dhe unë jam këtu dhe ju thash në fillim se ju garantoj që Qeveria qëndron rishtas me rifuqizim dhe dje që patëm në seancë, draftit të parë i cili është prezentuar. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Unë nuk do t'ju jap fjalë më, se po përsëriten gjërat. Me Rregulloren tonë, Qeveria bën amendamente por nuk bën ministria. Të gjitha sendet janë arsyetuar dhe kot humbim kohë. Ne kemi tre propozime rend që vijnë dhe unë po i shoh e të cilat kanë propozuesin me të njëjtin formulim – Qeveria me përkrahje të ... Qeveria me përkrahje... Qeveria me përkrahje...

Ne kemi të propozuar në dokumente si të tillë. Më herët ne kaluam këtë problem, gjatë votimit të këtij ligji. Nuk më mbetet tjetër, por komisionet kryesore ose të tërhiqen nga këto propozime dhe mbetet pa objekt, ose të votojmë për këto dhe të shohim me vota si do të shkojë. Atë detyrë e kanë ato. Sepse, këta thonë jo ne e kemi përkrahë diçka që s'ka qenë në propozim.

HYDAJET HYSENI:

Më është marrë një herë sot e drejta për të bërë vërejtje procedurale, prandaj edhe është një arsye plus. Unë falënderoj ministrin ose do ta kisha falënderuar nëse do të arrinte të na sqarojë çka ka ndodhë atje dhe si duhet të veprojë qeveria. Se si duhet të veprojmë ne këtu, ju falemnderit shumë, por këtë e dijmë ne këtu. Me Rregulloren e Kuvendit, me të cilën ne punojmë, Rregulla 33, thuhet shprehimisht: Përveç amendamenteve të propozuara nga komisionet, Kuvendi shqyrton edhe amendamentet e propozuara nga Qeveria dhe nga grupet e deputetëve ose d eputetëve individual p ara s e t ë v endosë p ër m iratimin e s hqyrimit t ë d ytë. Megjithatë ky shqyrtim duhet të kalojë nëpër komisione e tjera, gjë që ju e dini. Ne nuk dijmë çka ka ndodhë në Qeveri. S'jemi as të obliguar ta dijmë. Kemi një procedurë zyrtare si komunikohet. Ne na janë sjellë amendamentet nga Qeveria. Ministria është pjesë e Qeverisë. Edhe më parë ka ndodhë që për një ligj të na sillen amendamente nga dy, tri ministri. Dhe, ne i kemi shqyrtuar të gjitha. Amendamenti mund të tërhiqet dhe këtë duhet ta bëjë sponzorizuesi, përfaqësuesi i qeverisë. Të... thotë, ky amendament tërhiqet, është procedurë e rregullt parlamentare. Por përderisa të mos bëhet kjo, ne nuk kemi si t'i konsiderojmë në bazë të një deklarate që përsëri e bën dikush tjetër tash e të thuhet se këto amendamente nuk janë... Kjo do të ishte sikur Grupi Palramentar i Partisë Demokratike, ose një komision parlamentar të theksojë se nuk janë ekzistente amendamentet e një komisioni ose një grupi tjetër parlamentar. Është krejt absurde.

Prandaj, unë propozoj që të shqyrtohen amendamentet siç janë propozuar nga komisionet dhe derisa komisionet kanë qenë unike në këtë rast është krejt irelevante se a i ka propozuar kjo ministri apo ajo ministri. Me rëndësi është – kanë ardhur nga Qeveria. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Unë duke rrespektuar Hydajetin se ka marak procedurat me i shpjegue, falemnderit. Ti u ndale deri te pika, unë po vazhdoj. Megjithatë, thotë neni, që e lexoni ju zoti Hydajet, ai duhet të shqyrtojë vetëm amendamentet që i ka paraqitur komisioni funksional. Krejt ato që thua ti janë në rregull, është empiri, por në fund, megjithatë duhet një propozues dhe unë po kërkoj propozuesin zotëri. Prandaj, e kërkoja artikulimin e komisioneve sepse ata janë meritore që të votohet diçka. Le të thonë ata, ne e qesim në votim. Unë dua mbështetje.

A jeni ju propozues të këtyre komisionet? (**Prej së largu: Jo**).

Urdhëro, por kurgjë s'ke çka sqaron... Është kaq e qartë sa që s'ka nevojë të dalësh.

FATMIR REXHEPI:

Kryesuesi po thotë kurgjë s'ke çka sqaron. Falemnderit. Mirë, është tjetër punë a beson a s'beson. Po flas, Komisioni funksional për ekonomi e financa, që është më i thirruri në këtë temë të diskutojë as amendamentin 17, as atë 18, as atë 19 nuk i ka përkrahë. Ka dhënë mendimin e plotë, prandaj ne kemi diskutue. Nëse kjo nuk është në rregull, le ta thonë. Pra, nëse veç thuhet edhe atje që Komisioni funksional është më i thirruri, po them në emër të Komisionit funksional. Ndërsa sa i përket asaj tjetrës që kam thënë atë ditë për anëtar të Kryesisë, do ta iniciojmë procedurën e ndryshimit të Rregullores sepse edhe ashtu tepër është bërë kjo këtu në foltore.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Të falemnderit. Komisioni funksional edhe ashtu këtu s'ekziston por janë këto dy tjerat që e përkrahin. Domethënë është e qartë se Komisioni funksional nuk është në asnjërin prej këtyre tri amendamenteve që po i diskutojmë ne. Unë e pranoj këtë, por domethënë s'është ai problem hiq. Problemi është i dy tjerave. Urdhëro, s'është vonë kurrë nëse keni argument.

Vë në votim amendamentin 17, që thotë: Qeveria (por s'është Qeveria), me përkrahje nga komisionet kryesore, por jo nga Komisioni funksional.

Kush është për, le ta çojë dorën. Për 21.

Kush është kundër? 41 kundër.

A abstenon kush? 8 abstenime.

Amendamenti 17 nuk miratohet.

Amendamenti 18, Me përkrahje nga komisionet kryesore por pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për? 21 për.

Kush është kundër? 47 kundër.

Kush abstenon? 7 abstenime.

Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 19, Me përkrahje nga komisionet kryesore, pa përkrahje të Komisionit funksional.

Kush është për? 22 për.

Kush është kundër? 40 për.

A abstenon kush? 7 abstenime.

Nuk miratohet ky amendament.

Amendamenti 20. Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga Komisioni i komuniteteve dhe pa përkrahje nga Komisioni për buxhet.

Urdhëroni...

SADUDIN BERISHA:

Meqë kryesuesi i Komisionit për komunitete nuk merr fjalën, unë pak më parë e përsërita – Komisioni për komunitete nuk i ka diskutuar fare amendamentet e asnjë komisioni apo grupi parlamentar. Këtu thuhet diç tjetër. Në të vërtetë duhet të shiqohet Sekretaria çka punon dhe si punon. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Mirë. Ju falemnderit. E ka fjalën Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI:

Ky amendament është miratuar nga Komisioni funksional për ekonomi dhe financa, por jo edhe nga Komisioni për buxhet. Unë kam për detyrë si eksperte në këtë lëmi të jap një sqarim. Neni 16. Në nenin 16, kam propozuar që në vend të "barrës" të jetë "peng". Ky propozim është në përputhje të plotë me objektin që merr në trajtim ky nen i këtij Ligji. Fjala është për pengun, si garanci e pagesës në regjistrin e të drejtave për pronën e paluajtshme. Ky propozim është po ashtu në frymën dhe në përputhje të plotë me versionin në gjuhën angleze. "Lien", në gjuhën angleze do të thotë peng.

Në versionin në gjuhën serbokroate "zallog" është peng. Për të përforcuar dhe justifikuar edhe më tepër propozimin tim se në vend të termit "barrë" duhet të jetë "peng" do të paraqes në vijim se çka është barra reale.

Barrët reale janë institut tipik i të drejtës feudale të cilën e kanë trajtësuar veçanërisht pandektistët. Doktrina juridike zvicërene i kritikon barrët reale duke konsideruar se ato nuk janë afirmuar në praktikë kur kanë të bëjnë me veprimet ose në favor të pronarit të përhershëm të ndonjë pasurie. Ekzistojnë...

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Nerxhivane, të lutem, tani po kalon në teori. Ne kemi shumë të qartë çka po don ti. Duhet të merret "peng" dhe propozimi është i qartë. Më tutje s'besoj se ke nevojë, ma merr mendja, të vazhdosh. Të falemnderit.

Domethënë, kemi amendamentin. Propozuesja dha sqarimin për të. Është e natyrës dhe unë për hesap timin më shumë saktësim terminologjik se sa problem substancial. Ka një mbështetje, në princip, të Komisioneve të komuniteteve sepse përfaqësuesi i tyre tha se në detaje as që i diskutojnë këto nene por japin mendimin e tyre a shkelen të drejtat e tyre dhe ekziston një pajtim i Komisionit funksional sa u tha dhe një mospajtim nga Komisioni i buxhetit.

Vë në votim amendamentin 20.

Kush është për? Ju falemnderit. Shumica është për.
Kush është kundër? 14 janë kundër.
A abstenon ndokush? 7 abstenime.
Amendamenti 20 miratohet.

Amendamenti 21, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Shumica. Ju falemnderit.
A ka kush kundër? 14 kundër.
A abstenon ndokush? 4 abstenime.
Amendamenti 21 miratohet.

Amendamenti 22, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Ju lutem, kush është për? Shumica. Ju falemnderit.
A ka kush kundër? 14 janë kundër.
Kush abstenon? 2 abstenime.
Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23, Kemi dy propozime të ndryshme:
a) Komisioni për buxhet, me përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni i komuniteteve, dhe
b) Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga Komisioni i komuniteteve dhe pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Vë në votim variantin a) Komisioni për buxhet, me përkrahje nga Komisioni funksional dhe Komisioni i komuniteteve.

Kush është për? 38 për.
Kush është kundër? 10 kundër.
A abstenon ndokush? 10 abstenime.
Miratohet varianti a) dhe në këtë rast b)-enë nuk kemi përse ta votojmë sepse është alternativë e tijë.

Amendamenti 24, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga Komisioni i komuniteteve dhe pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Komisioni funksional çfarë qëndrimi ka. Le të sqarohet nga foltorja, ju lutem.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Mendoj se zoti Bjeliq ka dashur të dalë në këtë rast siç tha edhe një parafolës pjesëtar i Komisionit, por ai nuk po del kështu që nënkryetari ndoshta do të duhej por që s'doli prapë. Mendoj se duhet të them që kemi përkrahur këtë si Komision e kurgjë tjetër.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Domethënë, ka përkrahjen tuaj. Këtë duhet ta thuani në foltore, zotëri. S'dyshoj unë në juve. Meqë s'shkruan këtu ta regjistrojmë disi.

Pra, e kemi kështu, amendamenti 24 – deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga Komisioni funksional, Komisioni i komuniteteve dhe pa përkrahje të Komisionit të buxhetit.

Ju lutem kush është për? Ju falemnderit. Shumica është për.

Kush është kundër? 14 kundër.

Kush abstenon? 3 abstenime.

Amendamenti 24 miratohet.

Amendamenti 25, Deputetja Nerxhivane Dauti, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Shumica është për. Ju falemnderit.

Kush është kundër? 14 vota kundër.

Kush abstenon? 2 abstenime.

Miratohet amendamenti 25.

Tash jemi në fund të kësaj procedure. Unë do t'ju lutja, kolegë të mij të çmuar edhe një herë te amendamenti i propozuar nga zonja Gaxherri, rreth asaj që propozon një shtesë – amendamenti 12 pika f). Në procedurat ekzistuese parlamentare që i kemi këtu, sot do të ishte vonë të merremi me të. Të gjithë pajtohen këtu, edhe konsultimet që kisha me tjerët, që është i domosdoshëm të bëhet ky amendament. Kërkoj nga ju, që në princip, ne të votojmë, të votojmë “për” nëse dojmë dhe të shikohen mundësitë në mënyrë që të mos jemi mbrapa me këtë materie të cilën ne e konsiderojmë të domosdoshme. Prandaj, ju thërras të votojmë për këtë.

A jeni për këtë formë të miratimit? (**Prej së largu: Po.**) Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër? 4 abstenime.

(Nga vendi: Jesmo protiv ovakvog načina glasanja)

Aha, jeni kundër procedurës së votimit, kësaj radhe. Po mirë de! Nejse, jo kundër amendamentit, por kundër procedurës janë 3-4 vetë!

Kush abstenon nga votimi? Ju falemnderit shumë.

Unë konsideroj se ne kemi aprovuar në nivel të Kuvendit një amendament të tillë i cili është i domosdo. Unë më shumë e vëra në votim duke marrë parasysh sepse ka shumë problem që po thuhet se nëpër Sekretari, për shkak të ngutisë, nuk kanë kaluar. Unë kam një arsytim prej propozuesit që ky në komisione ka kaluar por nuk është regjistruar dhe me këtë argumentim unë kalova deri këtu.

Së pari, t'ju them se në seancë janë të pranishëm 97 deputetë, prandaj kemi kuorum të nevojshëm për vendimmarrje të plotëfuqishme.

Tash, ju lus ta votojmë në tërësi Ligjin me amendamentet e propozuara dhe të mriatuara këtu.

Kush është për, ju lutem le ta çojë dorën. Ju falemnderit. Shumica janë për.

Kush është kundër? 14 kundër.

Kush abstenon? 3 abstenime.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForShumica – Veçina – Majority....

Kundër – Protiv – Against 14

Abstenuan – Uzdržani – Against 03

Po shpall se u miratua Ligji për vendosjen e tatimit në pronën e paluajtshme në Kosovë me shumicë votash; 14 kundër dhe 3 abstenime.

(Duartrokitje)

Kalojmë në pikën e katërtë të rendit të ditës – **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kooperativat bujqësore.**

Deputetët kanë marrë këtë Projektligj më 17 mars 2003.

Ftojme ministrin respektiv Bogdanoviq, që në emër të Qeverisë, ta bëjë paraqitjen e Projektligjit para deputetëve.

BOGOLJUB BOGDANOVIĆ:

Poštovano Predsedništvo, poštovani poslanici,

Cilj izrade Zakona o zadrugama je stvaranje povoljnog okruženja za napredovanje, jaćanje i celokupni razvoj seoskih organizacija, u prvom redu poljoprivrednih zadruga, udruživanje poljoprivrednika sa akcentom povećanje sredstava za život članova zadruga i zadrugara i promovisanjem razvoja poljoprivrede na ovim prostorima. Dalji ciljevi Zakona su udruživanje resursa pojedinih članova i stvaranje krupnog kapitala kako bi se povećala proizvodnja i poboljšale usluge članova zadruga, kao što su zajedničko korišćenje opreme i konsolidovanje upotrebe zemljišta sa proširenjem zemljoradnje, zatim olakšanje pružanja usluga zadrugarima kao što su

snabdevanje sirovinama, olakšavanje pristupa kreditnim i finansijskim institucijama, što bi stvorilo pogodnu osnovu i uslove za obezbedjenje procesa razvoja sela.

Na Kosovu je bilo registrovano oko 150 zemljoradničkih zadruga. Većina njih sada su u veoma teškoj situaciji zbog nedefinisanja vlasništva zadruga i zbog nedostatka finansijskih sredstava u ovom trenutku.

Da bi prevazišli taj problem, mi smo bili prinudjeni da uradimo Nacrt zakona i mislim da će usvajanjem Nacrta ovog zakona doći do poboljšanja, tojest do razvoja poljoprivrede i rasta produktivnosti rada, prevashodno zemljordnika, u ovom slučaju.

Sadržaj ovog Zakona tojest Nacrta zakona, videli ste jer ste i sami dobili taj Nacrt zakona, u osnovi na čemu se orijentiše ovaj Zakon o zadrugama. Ali ja ću vam ovde isto reći, znači na ovaj Nacrt zakona, koji su glavni ciljevi i na što se najviše orijentiše. To je osnivanje i registracija poljoprivrednih zadruga; članovi zadruga; federacija zemljoradničkih zadruga; deoničarski kapital; zatim sledi poglavlje gde ima upravljanje zadrugama, tojest organi zadruga. Koji su organi – to su skupština; spoljno-finansijska kontrola; upravni odbor; predsednik i direktor zadruga, i ujedno, naravno nadzorni odbor.

Ovim Nacrtom zakona je predvidjeno da se zemljoradničke zadruga osnivaju na ugovorenim osnovama od fizičkih i pravnih lica koja se bave poljoprivredom i koja održuju svoja privatna materijalna dobra i prava u zadruzi radi usavršavanja i proširenja njihove poljoprivredne delatnosti, povećanjem proizvodnje i iskorišćavanjem njihove imovine.

Zemljoradničke zadruga, po ovom Nacrtu zakona, su neprofitabilne, što znači da ne osnivaju se na principu sticanja dobiti za sebe, znači to je vrlo bitno u ovom trenutku, nego za usluge svojih članova tojest zemljoradnika koji će biti uključeni u te zadruga. I kao takve one imaju posebne olakšice u svom poslovanju. Dve ili više zadruga mogu se udružiti u urduženje poljoprivrednih zadruga radi vršenja određene delatnosti. Da vam ja sada ne bih nabrojao koje delatnosti... neko već to i zna. Moram još nešto istaći. Ko je učestvovao u ovo i ko nam je pomagao Ministarstvo poljoprivrede u izradi ovog Zakona. Imali smo veliku pomoć i održku od jednog projekta, zvanog PASK – znači program pomoći sektoru zadrugarstva, koji je finansirala Francuska vlada, tojest radne organizacije i drugih međunarodnih lokalnih stručnjaka s kojim smo vršili konsultacije i organizovali seminare o ovom Zakonu. Tu su učestvovali zastupnici svih zemljoradničkih zadruga na Kosovu, koje postoje u ovom trenutku, učestvovali su naravno sa celog Kosova, uzimajući u obzir i sever Kosova gde smo mi jednim aktivnošću uspeli da i mišljenje tih ljudi isto uzmemo u obzir i naravno svi drugi zainteresovani subjekti kome je stalo do razvoja zadrugarstva na Kosovu. Hvala vam!

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Falënderojmë ministrin për hyrjen që bëri. Tash do të debatohet në parim sot por jo për detaje për Ligjin. Kërkoj që në emër të komisionit gjegjës të kësaj ministrie të marrë fjalën. E ka fjalën Sutaj...

ISUF SUTAJ:

E nderuar Kryesi, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra,
Këtu para nesh kemi një Ligj i cili rregullon një materie për shërbim të popullatës, e cila merret me bujqësi. Në parim, kësisoj e kam kuptuar. Do të thotë Ligji mbi organizimin e kooperativave bujqësore, që në të ardhmen do të licencohen në bazë të këtij Ligji dhe do të veprojnë në Kosovë, ka për qëllim që këto kooperativa t'u ndihmojnë bujqve në kryerjen e detyrave të tyre. Mirëpo, një gjë, ky ligj, nuk e definojnë për këtë fazë. U përmend këtu se kemi 150 kooperativa bujqësore të nivelit të kaluar, do të thotë të para luftës, të cilat me këtë Ligj nuk definohet se si do të bëhet ritransformimi i tyre në bazë të këtij ligji për në të ardhmen, ku aty presin, t'ju them sinqerisht, një numër bukur i madh i punëtorëve që aty t'u definohet statusi për në të ardhmen. Do të thotë, ky ligj këtë vetëm e përmend, por nuk e definojnë se ata si do ta bëjnë këtë transfer, si do të kalojnë në shoqatat e ardhshme aksionare kooperativiste, për arsye se kjo punë për ta është shumë fundamentale. Ligji definojnë atë se këto kooperativa do të jenë në formën aksionare, do të funksionojnë si njësi kooperative, si bashkësi e kooperativave, do të jenë joprofitabile që është mirë, do të kenë vetëm një organ ekzekutiv i cili do të paguhet ai, do të jetë drejtori, që unë kuptova, në atë aspektin tim dhe do të thotë edhe kjo është mirë dhe i definojnë disa gjëra që në të ardhmen kooperativat do të luajnë një rol të rëndësishëm në kushtet dhe rrethanat që ka Kosova. Mirëpo, thash, nuk e definojnë atë, ndoshta ajo do të jetë prapë në ato suaza që ka AKM-ja për çështjen e pasurisë së paluajtshme që kanë pronat shoqërore dhe aty po lind ai problemi që shumë punëtorë tash po presin dhe janë duke pritur këtë ligj, sikurse edhe për shumë organizata tjera publike, shoqërore dhe shtetërore që kanë qenë. Në parim ky Ligj duhet të përkrahet, do të thotë me ato gdhendjet që do t'ia bëjnë nëpër komisione dhe duhet që të punohet dhe kur të përmirësohet edhe të përkrahet përfundimisht me amendamente. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Të falemnderit zoti deputet. Fjalën e ka Sebahate Grajçefci.

SEBAHATE GRAJÇEVCI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë, ministra,
Është ky Projektligji i tretë nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që po e trajtojmë dhe më vjen mirë që këta dy të fundit janë punuar mjaft mirë për ç'arsye e përgëzoj edhe Ministrinë dhe hartuesit e këtij ligji.

Të nderuar deputetë, duke patur parasysh faktin se Kosova, përmendi edhe ministri, ka rreth 150 kooperativa, them rreth 150 sepse disa prej tyre funksionojnë dhe disa jo dhe mungesa e ligjit, ne e dimë se kishte ligje, por ligjet e mëparshme tashmë janë të tejkaluara pas zhvillimeve në Kosovë dhe rajon. Pra, themi se mungesa e ligjit ka vështirësuar funksionimin e tyre, sidomos viteve të fundit, meqë as kooperativat nuk i kanë shpëtuar shkatërrimit të mjeteve të tyre themelore qoftë të objekteve, mekanizmit bujqësor apo mjeteve jtë tjera. Prandaj, një numër i konsiderueshëm i tyre nuk kanë mund të aktivizohen por shumë nga këto kooperativa

edhe pse funksionojnë më tepër janë marrë me veprimtari tregtare se sa që kanë qenë në shërbim të bujqve, për çka edhe e kanë patur rolin.

Prona e tyre ka qenë e padefinuar, herë shtetërore e herë private dhe kjo çështje akoma mbetet e paqartë dhe as me këtë Ligj nuk do të rregullohet.

Mungesa e ekspertëve dhe mjeteve financiare po ashtu ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga vështirësitë me të cilat sot ballafaqohen kooperativat. Prandaj, mua më vjen mirë që ky Ligj do t'i rregullojë një varg paqartësish qoftë për funksionimin e kooperativave.

Mund të them se është një prej projektligjeve të punuara mjaft mirë meqë ka për model ligjin francez për kooperativat dhe Franca është vendi që ka më së mirë të zhvilluar kooperativizmin dhe gjithashtu ky projekt i hartuar i përshtatet mjaft situatës në Kosovë dhe kushteve të tregut. Sipas tij, kooperativat kryejnë veprimtari shërbyese, jo fitimprurëse dhe ka për qëllim që t'i ndihmojë bujqit që në mënyrë të organizuar qoftë të furnizohen me repromaterial, farë, pleh e tjera, qoftë edhe të ndihmojë njëri-tjetrin me mekanizëm bujqësor si dhe të ndihmohen për plasimin e prodhimeve të tyre. Prandaj, si të tilla kooperativat nuk do të tatimohen. Ky ligj po ashtu rregullon funksionimin e brendshëm të kooperativave me kooperuesit, raportet, rolin dhe kontributin e kooperuesve, mënyrën e udhëheqjes dhe të marrjes së vendimeve por edhe sanksionet me rastin e moszbatimit të Ligjit.

Projektligji për kooperativat bujqësore është i shkruar qartë dhe mendoj se përveç disa ndërhyrjeve të vogla, në përmbajtje nuk do të ketë nevojë të ndërhyhet aq shumë, sidomos kur kemi parasysh se shumë çështje do të rregullohen edhe me akte tjera normative më të ulta se ligji.

Prandaj, unë dhe Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, përkrahim miratimin e këtij Projektligji në parim dhe kërkohet që të procedohet më tutje ashtu që sa më shpejtë të mund të zbatohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Falënderojmë zonjën Grajçevci. Fjalën e ka Berat Luzha.

BERAT LUZHA:

Të nderuar deputetë, Propozimligji për kooperativat bujqësore meriton komplimente sa i takon hartimit të tij. Është i shkruar rrjedhshëm, pa gabime, thjeshtë dhe qartë. Mirëpo, nga ana përmbajtësore atij i mungon shumëçka. I mungon sidomos qasja për rregullimin ligjor të ish kooperativave bujqësore, të cilat tash janë pa status juridik. Në këtë propozimligj për këto kooperativa është shkruar vetëm një pikë dhe atë në nenin e fundit të tij. Në këtë pikë, ish kooperativat bujqësore, që siç u tha janë 150 sish ose kanë qenë të tilla obligohen të reregjistrohen sipas këtij Ligji brenda afatit kohor njëvjeçar, në të kundërtën do të shpërbëhen fare. Mirëpo, nuk tregohet se me çfarë statusi do të punojnë ato, çfarë statuti do të hartojnë ato,

kur dihet se statusi juridik i tyre është si organizatë shoqërore dhe nuk përputhet me normat e këtij Ligji të propozuar. Me këtë Ligj do të rregullohen normat për funksionimin e kooperativave vetëm mbi bazën e aksioneve, domethënë të kooperuesve privat dhe jo të kooperativave shoqërore. Prandaj, çështja e ish kooperativave bujqësore mbetet pezull ende, pra mbetet e pazgjidhur edhe me këtë ligj. E pazgjidhur mbetet gjithashtu edhe çështja e pronës së ish këtyre kooperativave, e cila po tjetërsohet gjithnjë e më tepër. Dihet se toka që kanë apo e kanë pasur në dispozicion këto kooperativa kryesisht kanë mbetur e djerrë ose të shumtën iu është dhënë për punim me qira simbolike bujqve privatë. Kemi shumë raste të uzurpimit të tokës nga persoant e cila ndodh të parcelizohet dhe të shitet si tokë private. Raste të tilla kemi për shembull në Matiçan, në Veternik, Laple-sellë e tjera, e tjera. Kurse, ish kooperativat bujqësore tash për tash nuk kanë mundësi financiare dhe mekanizëm por as mundësi ligjore për ta mbrojtur pronën e vet në tokë të cilën e kanë shfrytëzuar deri para disa vjetëve. Të bëhet një ligj për kooperativat bujqësore dhe të lihen jashtë ligjit 150 kooperativat bujqësore, vërtetë është një absurd.

Dihet se formimi i kooperativave bujqësore në të kaluarën, sidomos pas luftës së dytë botërore, është mbështetur në ekspropriimin apo konfiskimin e pronave private dhe të tokave të përbashkëta të fshatarëve siç janë lëndinat, kullosat e tjera. Në shumë raste, fshatarët i kanë ruajtur tapitë dhe dokumentet tjera për tokën e marrë, ndonjëherë ata edhe kanë vepruar duke kthyer pronën e tyre kryenëvete, domethënë pa procedurë ligjore.

Agjencia e mirëbesimit ende nuk ka bërë asnjë hap për transformimin e pronësisë së tokës, madje si duke tende nuk ka hartuar as strategji për këtë qëllim. Me këtë tempo, privatizimi i tokës do të zvarritet tepër shumë dhe Kosovës do t'i kushtojë jo vetëm nga aspekti bujqësor por edhe në zhvillimin e gjithmbarshëm të saj. Do të duhej që toka bujqësore të kalonte nën menaxhimin e institucioneve të vendit, pra të Qeverisë dhe të ministrisë përkatëse dhe pastaj menjëherë të fillonte privatizimi i saj.

Propozimligji për kooperativat më shumë i përngjet një statuti të një kooperative bujqësore se sa të një ligji. Kjo tregon se sa janë të kufizuara kompetencat sipas këtij ligji pasi të miratohet.

Nga ana tjetër, do të ishte tepër i vështirë funksionimi i Ligjit, konkretisht funksionimi i kooperativave mbi bazën aksionare derisa nuk janë rregulluar me ligj edhe disa probleme të tjera kushtëzuese, si është çështja e mbrojtjes së prodhimeve bujqësore të vendit, çështja e regresimit të bujqve, e kreditimit të tyre, e tjerë. Prandaj, nuk pres që ky Ligj do të bëjë kthesë për zhvillimin e bujqësisë në Kosovë.

Dhe, krejt në fund, bujkun tonë tradicional e kemi shndërruar në fermer. Sipas kësaj logjike, edhe kooperativat duhet të quhen kooperativat fermere, kurse bujqësia të quhet fermeria. Nuk ka asnjë arsye t'u ikim fjalëve të gjuhës sonë, si është në këtë rast fjala bujk, kur dihet se ato shqiptohen shumë më lehtë dhe tingëllojnë shumë më bukur.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah miratimin e këtij Ligji në parim por kërkon zgjerimin e tij me amendamente të reja që me siguri do t'i bëjë Komisioni funksional dhe të tjerët.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka Zyhrije Maloku.

ZYHRIJE MALOKU:

I nderuari zoti kryesues, të nderuar ministra, kolegë deputetë,
Unë do të jam e shkurtër në diskutimin tim dhe do të mundohem të rrespektoj kohën të cilën e kemi në dispozicion të paraparë sipas Rregullores së punës të Kuvendit.

Projektligji i propozuar për formimin e kooperativave bujqësore në Kosovë krijon një kornizë adekuate ligjore dhe në mënyrë të qartë përcakton standardet dhe procedurën të cilën duhet zbatuar për t'u formuar një kooperativë bujqësore. Ligji i propozuar përmban gjithësej 23 nene, ku në mënyrë shumë të qartë jipen çështjet thelbësore dhe kushtet themelore për formimin e një kooperative siç janë regjistrimi në zyrën adekuate, bashkimi i 10 e më shumë fermerëve që janë nënshkrues të detyrimeve e tjera. Me këtë ligj është lehtësuar edhe formimi i kooperativave bujqësore sepse një kooperativë e tillë mund të formohet edhe prej 2 fermerëve të cilët veprimtari të veten kanë shfrytëzimin e përbashkët të mekanizmit. Po ashtu, në këtë Ligj janë përshkruar në mënyrë të hollësishme edhe detyrat e çdo anëtari të kooperativës mirëpo një çështje mendoj se nuk është qartësuar sa duhet kur është fjala për largimin e anëtarit nga kooperativa. Në Ligj thuhet se anëtari i kooperativës mund të tërhiqet nga kooperativa me kërkesë për tërheqje e cila ushtrohet 6 muaj para skadimit të afatit por të cilën anëtari është i anëtarësuar apo para tërheqjes. Nëse anëtari i kooperativës ka obligime ndaj kooperativës, statusi i anëtarit i pushon para përmbushjes së obligimeve. Këtu shtrohet pyetja – çfarë do të ndodhë nëse anëtari nuk i përmbushë obligimet ndaj kooperativës. Kuptohet se statusi i anëtarit skadon ditën e caktuar për përjashtim mirëpo çfarë do të bëhet nëse ai i ka mbetur borxh kooperativës. Kush do ta paguajë borxhin e tij.

Mendoj se vlenë të përmendët edhe një çështje tjetër me rëndësi që trajtohet në këtë Ligj e ajo është trashigimia. Pra, në bazë të këtij Ligji, nëse ndonjë anëtar i kooperativës vdes nga shkaqe të ndryshme, atë mund ta zëvendësojë ndonjë nga trashigimtarët e tij, me të drejtat dhe obligimet e anëtarit të vdekur nëse i plotëson kushtet për fitimin e statusit të anëtarit të kooperativës. Mirëpo, edhe këtu ndoshta ndokush mund të parashtrijë pyetje – çfarë ndodhë nëse anëtari i vdekur nuk ka asnjë trashigimtar, kush do ta zëvendësojë atë, kujt do t'i përket pasuria e tij. Është mirë që kjo çështje të definohet me ligj.

Duke patur parasysh se është leximi i parë dhe në parim, mendoj se ky ligj është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për aprovim në këtë Kuvend, sepse është i nevojshëm në plotësimin e zbrastësirave që kanë përcjellur Kosovën vite me radhë dhe në mungesë të këtij ligji shumë pasuri bujqësore nuk janë shfrytëzuar si duhet dhe sa duhet. Andaj, aprovimi i këtij Ligji do të ndihmonte bujqve kosovarë në punën e tyre sa më të suksesshme dhe frytdhënëse. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit, zonja Maloku. Fjalën e ka Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI:

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Duke mbështetur në parim Ligjin për organizimin e kooperativave bujqësore në Kosovë, mendoj se aprovimi i këtij Ligji do të jetë edhe një stimulim i mirë për sektorin privat të bujqësisë duke patur parasysh rëndësinë që ka dhe gamën e shtrirjes së aktiviteteve të ekonomisë familjare që ka në Kosovë dhe me gjithë këto, brenda këtij Ligji janë mjaft të ndërtuara të gjitha të drejtat e sektorit privat gjegjësisht atyre të cilat do të marrin pjesë përmes aksioneve së tokës së tyre, të cilët do të kenë formën e organizimit prej kuvendit, menaxhimit të këshillit drejtues dhe të gjitha të drejtat tjera. Të gjitha këto e thjeshtësojnë gjegjësisht e ndihmojnë organizimin e këtij sektori në Kosovë dhe përmes këtij Ligji besoj se me hapa më të mirë do të ecë prodhimtaria vendore sa i përket sektorit të bujqësisë.

Prandaj, edhe një herë theksoj se mbështes këtë Ligj dhe besoj se ky ligj do të ndihmojë shumë zhvillimin e sektorit privat të bujqësisë. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka kërkuar Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra,

Propozimligji mbi kooperativat bujqësore mendoj se ka disa të meta formalo-juridike të cilat, mendoj se ministria konkrete, gjegjësisht propozuesi, do t'i eliminojë. Sidoqoftë, edhe vetë emërtimi i këtij Ligji – kooperativat bujqësore, nuk tingëllon mirë dhe drejt me rrjedhat e tanishme që po pason shoqëria jonë në tërësi. Mendoj se Ligji duhet të ketë më tepër emërtimin – ligji mbi kompanitë bujqësore ose ligji mbi bashkimin e bujqëve. Por, duke patur çdoherë parasysh edhe pronën e kooperativave bujqësore e cila në të kaluarën ishte dhe buronte nga konfiskimi i pasurisë, nga nacionalizimi i pasurisë dhe shpeshherë këto kooperativa bujqësore ishin ngritur edhe mbi pronën shtetërore dhe pastaj ajo u transformua në pronë shoqërore, mendoj se bashkimi në kooperativa bujqësore duhet të jetë i përcaktuar mbi kontratat për bashkimin në kooperativat apo në kompanitë bujqësore, gjegjësisht mbi bashkimin e bujqëve... E dyta, mbi të drejtën e pronës së konfiskuar, ose të nacionalizuar dhe jo mbi kriteret që përcakton; Dhe e katërta, mbi të drejtën e interesit të bujqëve dhe mbi të gjitha për të drejtën e punës së punëtorëve që kanë punuar në këto kooperativa.

Duke inkorporuar këto sygjerime, mendoj se kemi arsye dhe nevojë ta kemi një ligj që rregullon çështjen e bashkimit të bujqëve. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Nuk ka deputetë tjerë të paraqitur për ta marrë fjalën. Nëse s'ka edhe nga ana e Qeverisë të paraqitur për fjalë... Urdhëro.

MILOVAN JOVANOVIĆ:

Gospodo poslanici, hteo sam samo kratko da kažem da mi nismo za procesuiranje ovog zakona iz prošlog razloga što nije rešen svojinski kompleks. Ovde imamo, imam jedan materijal koji smo davno dobili i koji se zove - Oblikovanje pravnog sistema tržišne privrede, koji ste svi... Dakle preporuke kosovskih eksperata za reformu. U njemu stoji mnogo toga što treba da se uradi pre nego što se predje na neke systemske zakone, tako da smo iz tog načelnog razloga mi protiv procesuiranja ovog zakona. Hvala, najlepše.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Falënderojmë. Urdhëroni...

MEHDI BARDHI:

E nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,
Kur jemi duke shqyrtuar këtë Ligj, të themi Projektligj për kooperativat, unë sa e shoh, ky Projektligj nuk ka të bëjë me ish kooperativat. S'po them te kolhozat, telhozat, ose me pronat e patundshme që kanë pasur kooperativat, ky Projektligj ka të bëjë ekstra me një mënyrë të re të kooperimit, me një mënyrë të re dhe kështu s'di zoti ministri pse i përmendi për shembull 150 kooperativa. Ato do të rregullohen me ligje të tjera mbi pronën. Përndryshe, ky ligj nuk ka të bëjë me ish kooperativat dhe për atë flasim kot së koti. Në parim duhet të rregullohet diçka lidhur me këtë dhe unë përkrah në parim këtë Ligj. Ju falemnderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. Unë meqë nuk shoh interesim për të marrë askush më fjalën, vë në votim miratimin e këtij ligji, në parim.

Ju lutem, kush është për miratim të këtij Ligji në parim, le ta çojë dorën. Të gjithë jemi për...

A ka kush kundër? 2 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush s'abstenon.

Po shpall se me shumicë votash miratohet në parim ky ligj.

Njëkohësisht ngarkohen komisionet përkatëse që të merren me punën e përgatitjes sa më të shpejtë të këtij ligji, e që duhet brenda 3 javësh të kryhet ky ligj, por ju i kryeni kur të mundeni.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës – **Parashtrimi i pyetjeve të deputetëve.**

Jam i informuar se do të kemi përgjigjen gojore të ministrit të tregtisë dhe industrisë, zotit Ali Jakupi, në pyetjen me shkrim të deputetit Sahit Krasniqi. Ju lutem, urdhëroni merreni fjalën.

ALI JAKUPI:

I nderuari kryesues, të nderuara deputete, të nderuar deputetë dhe kolegë të mij ministra, Unë do të përpiqem shkurtimisht, por në mënyrë të argumentuar t'i përgjigjem pyetjes së deputetit të nderuar zotit Sahit Krasniqi që ka të bëjë me regjistrimin e bizneseve.

I nderuari deputet, Sahit Krasniqi, rrespekt. Kemi konsideratë të plotë për brengën tuaj lidhur me regjistrimin e bizneseve. Për të patur një pasqyrë më të qartë, ju informoj sa vijon:

Në kuadrin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, funksionon Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve i cili është i themeluar në bazë të urdhëresës administrative 2002/22. Bizneset e përkohshme gjatë administratës së UNMIK-ut deri tash janë regjistruar nëpër komuna. E njëjta gjë mund të bëhet edhe tash. Mirëpo, praktika ka dëshmuar diçka tjetër. Unë do t'i numëroj tash shkaqet për t'u përgjigjur në pyetjen pse është bërë bartja e këtyre funksioneve të regjistrimit nëpër zyra rajonale të ministrisë. Së pari kemi patur në disa komuna, jo në të gjitha, disa kushtëzime të cilat nuk shkojnë në favor të motivimit të regjistrimit të bizneseve të reja, por njëkohësisht kishte probleme edhe me reregjistrimet e bizneseve ekzistuese, për arsye se në disa komuna kompetentët nga ata që donin ta kryenin këtë punë, do të thotë t'i regjistronin ose t'i regjistronin bizneset kërkonin leje për ndërtim ku punohet në objektet ku duhet t'i paraqesin ose kontratat për qira, ose dëshminë për përmbushjen e obligimeve paraprake tatimore, pagesën e taksave shtesë që është në kundërshtim me rregullativën ligjore e çështje të tjera. Të gjitha këto që përmenda, janë në favor të pushteteve lokale, mirëpo këtu është problemi se nuk janë të sanksionuara me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/6 dhe urdhëresën administrative të UNMIK-ut të nënshkruar nga zoti Shtajner nr. 2002/22. Do të thotë këto kërkesa në aspektin praktik dhe të përmbushjes së arkës së buxheteve komunale, janë plotësisht të arsyeshme, që të kenë dokumentacion në rregull janë plotësisht të arsyeshme. Mirëpo, me qëllim që bizneset të bëhen në mënyrë sa më racionale, me një procedurë më të thjeshtësuar, pa shpenzime të mëdha, është paraparë që të kenë një procedurë e lehtë dhe për këtë arsye kjo procedurë nëpër disa komuna nuk është rrespektuar. Për t'i ikur këtij kushtëzimi që është bërë nga disa kompetentë, ne jemi detyruar që përkohësisht t'i tërheqim nga ato zyra funksionin e regjistrimit dhe reregjistrimit të bizneseve dhe ato punë i kemi bartë në agjencionet rajonale të ministrisë të cilat janë në Prishtinë, në Mitrovicë, Pejë dhe në Gjilan dhe kur ia bashkëngjesim edhe Agjencionin që punon pranë Ministrisë, domethënë janë 5 punkte ku mund të kryhet regjistrimi dhe reregjistrimi i bizneseve. Në këtë drejtim, edhe një sqarim dua t'ua them se me këtë ndonëse na duket paksa një humbje kohe për të shkukur prej atyre komunave ku nuk kanë qendra të tyre këto mundësi regjistrimi të bizneseve, duhet të udhëtojnë prej një komune në tjetrën, mirëpo dihet regjistrimi i biznesit bëhet rrallë, një herë, dy herë e tjera, prandaj nuk është ndonjë shpenzim i madh. E dyta, sipas punëve që kemi filluar efikasiteti është shumë i lartë në këtë drejtim. E treta, e rrespektojmë plotësisht procedurën ligjore dhe ligjet që janë në fuqi. E katërta, nuk maltretohen në asnjë mënyrë as nuk humbasin materialisht ata që i regjistrojnë dhe reregjistrojnë bizneset dhe kemi edhe shumë çështje të tjera të cilat tregojnë qartë se tashmë është arritur një efikasitet shumë i madh. Këtë mund ta dëshmojmë në çdokohë dhe çdokund dhe kemi mundësi ta ftojme edhe ndonjë deputet apo i afërm i tij që bën regjistrimi në biznesit se në këto kushte kemi arritur që regjistrimi ose reregjistrimi i bizneseve

të bëhet në mënyrë tepër efikase apo për 10, përkatësisht 15 minuta. Ky është një garancin që tregon një efikasitet.

Edhe diçka dua të përmendi, se për të vepruar kjo kështu, jemi të udhëzuar por edhe të menaxhuar edhe nga Banka Botërore e cila ka financuar Projektin e këtij agjencioni. Njëkohësisht nga përvoja e vendeve në rajon shihet se askund nuk ekziston regjistrimi i bizneseve nëpër komuna. Ju e dini edhe te ne, më parë, ka qenë në gjykatat ekonomike, ku është bërë regjistrimi i bizneseve, ndërkaq periudha e pasluftës, e menaxhaur nga UNMIK-u krijoi një mundësi që pranë komunave të regjistrohen bizneset e përkohshme. Ndërkaq, tani bizneset e përhershme, do të regjistrohen nëpër këto agjencione përkohsisht, ndërkaq posa të kryhet ai fluksi i madh që natyrisht reregjistrimet dhe regjistrimet do të bëhen brenda kësaj periudhe, atëherë tërë aktiviteti do të jetë i përqëndruar në Agjencionin e regjistrimit të bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë. Domethënë, nuk ka pse të shqetësohen fare komunat për këtë rast, për arsye se i kam të gjitha të dhënat, mos të humbi kohë, se vendet në rajon se si veprojnë e nëse doni edhe në shtetet tjera të cilat janë të zhvilluara dhe të cilat kanë aplikuar edhe ekonominë e tregut dhe kanë arritur një përvojë të gjatë. Domethënë, dëshirojam që t'ju sqarojmë se këtu është fjala pse i kemi ikur, do ta vazhdonim edhe nja dy muaj nëpër komuna por i kemi ikur keqpërdorimeve. Ka edhe keqpërdorime, edhe të vulave, sepse ne atyre iu japim vulat, domethënë vulat për secilën komunë, mirëpo jemi detyruar t'i tërheqim sepse nuk janë shkuar punët mirë prandaj ky është qëllimi ynë që ta rrespektojmë ligjin, t'i rrespektojmë ata që dëshirojnë të krijojnë biznese dhe të jemi efikas në punë. Ju falemnderit. Nëse keni ndonjë pyetje shtesë, unë ju përgjigjem.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Falënderojmë ministrin Ali Jakupi. E ka të drejtën deputeti Sahit Krasniqi që të japë komente shtesë. Urdhëroni...

SAHIT KRASNIQI:

I nderuari kryesues, me rrespekt ministra, dëgjova fjalën apo përgjigjen e ministrit por me keqardhje them se unë në pyetjen time kam dashur ta trajtoj një fenomen krejt tjetër ose një problem tjetër. Unë, nga komuna e cila vij këtu në Parlament, janë të regjistruara mbi 4.000 biznese të çfarëdo natyre qofshin apo madhësie. Për mua mbetet e pakuptimt që këta 4 mijë persona të shkojnë në Gjilan apo në Prishtinë për ta regjistruar apo për ta reregjistruar biznesin e vet. Ngjashëm ndodh edhe në komunat tjera në Kosovë, përveç atyre komunave që kanë fatin t'i keni zyrat regjionale në komunën e vet. Prandaj, për mua është e pakuptimt se deri tash janë regjistruar në zyrat komunale dhe unë do ta pranoj krejt atë që Ministria nëse shef të arsyeshme do ta dërgojë stafin e Ministrisë në komunë që t'i regjistrojë apo reregjistrojë ato biznese, ndërsa mbetet shumë e paqartë dhe për mua është e papranueshme që 4 mijë njerëz të detyrohen detyrimisht të shkojnë në një qendër për t'i regjistruar jashtë komunës me kilometra, kurse ka mundësi që të bëhet në komunën përkatëse.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. A dëshironi prap ta merrni fjalën? Urdhëroni...

ALI JAKUPI:

Dëgjoni, vetëm diçka të plotësoj. E thash, por s'di sa më keni përcjell. Lexoni Rregulloren 2001/6 për shoqëritë tregtare e për këto... Lexoni urdhëresën administrative të tetorit të vitit të kaluar 2002/22. Askund nuk janë të autorizuar me asnjë fjali, gjysmëfjalie dhe nuk shkruan se janë të autorizuar komunat të bëjnë regjistrimin e bizneseve për arsye se këto rregullore janë hartuar në frymën e përvojave në vendet e zhvilluara ku funksionon me sukses ekonomia e tregut. Prandaj, e dhe p se d uken 4 mijë, të kemi të q artë e dhe diçka, të gjitha të dhënat për dokumentacion dhe ato të regjistruara, për nja 50 mijë a sa kanë qenë subjekte të regjistruara, në ministrinë tonë dhe çdokush, nëse priton të shkojë në Gjilan, vjen për pazarë në Prishtinë, ka të drejtë me u kthye te ne në Agjencion, dhe për 15 minuta, e garantoj, ka me bërë regjistrimin. Domethënë, nuk është problem ai numër aq i madh.

KRYESUESI SABRI HAMITI:

Ju falemnderit. Ne përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Për fund kemi propozimin e rendit të ditës për Seancën plenare më 24 prill 2003. Kryesia ka miratuar rendin e ditës për këtë seancë me këto pika:

1. Shqyrtimi i nismës së Grupit Parlamentar të LDK-ës dhe të Komisionit për çështje juridike, legjislacion dhe kornizë kushtetuese për nxjerjen e ligjit për zgjedhjet;
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rrugët; dhe
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plehërat artificiale.

Po shpall të mbyllur seancën e sotme. Mirëupafshim në seancën e ardhshme.

Seanca përfundoi në orën 15,00.

Rt-1-49